



Kontrolli i Lartë i Shtetit

BULETINI STATISTIKOR
NR.4

Periudha
JANAR – DHJETOR 2020

Buletini nr. 4

Janar - Dhjetor

2020

Buletini i katërt statistikor i vitit 2020, përmbledh rezultatet e të gjitha auditimeve të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në periudhën janar – dhjetor 2020. Në këtë buletin përfshihen, dëmi ekonomik i konstatuar, të ardhurat e munguara dhe shpenzimet e kryera jo në përputhje me parimet e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit (3E), masat disiplinore dhe administrative të rekomanduara, si edhe kallëzimet penale të përcjella në Prokurori.

Buletini përgatitet nga Sektori i Komunikimit, Botimeve dhe e Marrëdhënieve me Jashtë (sektori i statistikës).

K Kontrolli i Lartë i Shtetit.

KLSH DHE AKTIVITETI AUDITUES PËR PERIUDHËN 2020		Faqe
I	TREGUESIT KRYESORË TË VEPRIMTARISË AUDITUESE	7
II	Shkeljet me dëm ekonomik	13
II.a	<i>Shkeljet me dëm ekonomik: Në fushën e të ardhurave</i>	14
	Në sektorin e Tatim-Taksave	15
	Në sektorin e doganave	16
	Në fushën e shitjes, blerjes dhe dhënies me qira të pasurisë shtetërore, marrëveshjeve hidrokarbure dhe kontratave koncesionare	17
	Në fushën të tjera	17
II.b	<i>Shkeljet me dëm ekonomik: Në fushën e shpenzimeve</i>	18
	Në fushën e pagave, shpërblimeve dhe sigurimeve shoqërore	18
	Në fushën e prokurimeve	19
	Në fushën e shpenzimeve operative	21
	Në fushën të tjera	22
III	Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara	22
III.1	Në fushën e të ardhurave	23
III.2	Në fushën e shpenzimeve	26
IV	Auditimet me opinion	35
IV.1	Dhënie opinionit për auditimet financiare	35
IV.2	Dhënie opinionit për auditimet e përputhshmërisë	36
IV.3	Dhënie opinionit mbi pasqyrat financiare dhe opinion mbi përputhshmërinë	38
V	Auditimet e Performances	39
VI	Auditimet e Teknologjisë së Informacionit	56
VII	Rekomandimet sipas natyrës	64
VIII	Kallëzimet penale	68
	Aneks	69
	<i>Evidenca nr. 1: Institucionet e audituara nga KLSH gjatë vitit 2020</i>	69
	<i>Evidenca nr.2: Shkeljet me dëm ekonomik</i>	73
	<i>Evidenca nr.3: Evidenca e pasqyrimit të parregullsive të dispozitave ligjore në fuqi, për të ardhura të munguara ose shpenzime jo në përputhje me parimet e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit</i>	74

<i>Evidenca nr.4: Masat Disiplinore dhe Administrative</i>	75
<i>Evidenca nr.5: Masat për Ndryshime apo Përmirësime ligjore</i>	76
<i>Evidenca nr.5.1: Masat Organizative</i>	77
<i>Evidenca nr.6: Kallëzimet Penale</i>	79
<i>Evidenca nr.7: Evidenca e ankesave dhe kërkesave drejtuar KLSH</i>	81

KLSH DHE AKTIVITETI AUDITUES VITI 2020

I. TREGUESIT KRYESORË TË VEPRIMTARISË AUDITUESE

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në cilësinë e institucionit më të lartë të auditimit të jashtëm publik, për vitin 2020 kishte planifikuar gjithsej 143 auditime, vijoi puna audituese për përgatitjen e 145 raporteve të auditimit, nga të cilat duke u orientuar drejt përmbushjes së detyrimeve ligjore janë evaduar 73 misione auditimi, si rezultat i rrethanave të shkaktuara nga ndikimi i pandemisë Covid-19.

73 misionet e auditimit të evaduara janë detajuar si më poshtë:

- 28 auditime përputhshmerie
- 16 auditime përputhshmërie dhe financiare¹
- 9 auditime performance
- 5 auditime financiare
- 4 auditime IT
- 11 auditime tematike

Rezultatet e punës audituese të vitit 2020 kanë pasur objektiv edhe identifikimin e shkeljeve dhe raportimin e tyre në bazë të klasifikimit si dëm ekonomik² dhe si parregullsi/paligjshmëri me efekte negative në financat publike nga subjekteve nën auditim³.

Niveli i dëmeve ekonomike dhe shpenzimeve joefektive të konstatuara nga KLSH gjatë periudhës vitit 2020 paraqitet si më poshtë:

Shkeljet me dëm ekonomik



Parregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, me dëm ekonomik në shumën totale prej 2,193,692 mijë lekë ose 17,7 milionë euro.



Indikatori i dobisë së auditimit (raporti i dëmeve të zbuluara nga KLSH në vlerën 2,175,398 000 lekë me shpenzimet buxhetore faktike të KLSH-së në vlerën 351,216,000 lekë) është 6,2.

¹ Në 16 auditimet e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë klasifikuar si auditime mikse janë dhënë opinione për pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë për 12 auditime.

² Dëmi ekonomik në aktivitetin auditues i referohet detyrimit të shpërblimit monetar të një individi ose subjekti që i shkaktohet autoritetit shtetëror të audituar në lidhje me veprime ose mosveprime në cenim të disiplinës financiare dhe kuadrit rregullator përkatës.

³ Efekti negative në performancën e subjekteve nën auditim i referohet efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimit me ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike.



Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në shumën totale prej 85,867,279 mijë lekë, afërsisht 694.1 milionë euro nga e cila:

I. 11,376,401 mijë lekë në fushën e të ardhurave, afërsisht 91.9 milionë euro;

II. 74,490,878 mijë lekë afërsisht 602.2 milionë euro, në fushën e shpenzimeve jo me eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve, si dhe shkelje të disiplinës buxhetore lidhur me likuidimin e shpenzimeve, keqmenaxhimin e fondeve të programuara apo mungesë kontrolli në realizimin e procedurave të prokurimit jo në përputhje me kuadrin ligjor.

Parregullsitë dhe paligjshmëritë e konstatuara, i referohen përdorimit të fondeve jo me eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet në fushën e prokurimit publik shoqëruar me mungesë kontrolli në realizimin e procedurave të prokurimit, të cilat në shumë raste rezultojnë të realizuara jo në përputhje me kuadrin ligjor.



Puna audituese është përqëndruar kryesisht në fushat për të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit ka vlerësuar një nivel të lartë risku. Edhe gjatë kësaj periudhe, shkeljet më të mëdha me efekte të konsiderueshme në buxhetin e shtetit dhe jo vetëm, lidhen me administrimin e të ardhurave: menaxhimin jo të kujdesshëm në procesin e përdorimit të fondeve publike; keq administrimin e pronës shtetërore ndjekur nga paligjshmëritë procedurale dhe ineficencat në realizimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe shkeljet në zbatimin e legjislacionit fiskal.

Përmbledhëse e shkeljeve me pasojë dëm ekonomik në Buxhetin e Shtetit në fushën e të ardhurave dhe shpenzimeve

Tabela nr. 1

I.	Dëm ekonomik në të ardhura	000/lekë
	Nga shkeljet në zbatimin e legjislacionit tatimor	1,038,069
	Nga shkeljet në zbatimin e kodit doganor	453,211
	Nga keqadministrimi i pronës shtetërore të dhënë me qera, marrëveshjet hidrokarbure dhe kontratat koncensionare	36,785
	Të tjera	190,052
	Totali i Dëmit ekonomik në të ardhura	1,718,117
II.	Dëm Ekonomik në shpenzime	
	Në shpenzimet për paga, sigurime dhe shpërblime	96,205
	Në shpenzimet operative	16,130
	Në shpenzimet për investime	337,927
	Të tjera	25,313
	Totali i Dëmit ekonomik në shpenzime	475,575
Totali i dëmit ekonomik (I+II) = 2,193,692 mijë lekë ose 17.7 milionë euro		

Të ardhura apo shpenzime të realizuara në kushtet e parregullsisë në zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi dhe në fushën e shpenzimeve jo me eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve për periudhën janar – dhjetor 2020.

Tabela nr.2



I.	Efekte Negative në të Ardhurat e Buxhetit	000/lekë
1	Nga shkeljet në zbatimin e legjislacionit tatimor	2,409,920
2	Nga keqadministrimi i pronës shtetërore të dhënë me qera, marrëveshjet hidrokarbure dhe kontratat koncesionare	99,598
3	Të tjera	8,858,755
4	Urbanistika	8,128
	Totali	11,376,401

II.	Efekte Negative për Shpenzimet e Buxhetit	000/lekë
1	Në shpenzimet për paga, sigurime dhe shpërblime	664,623
2	Në shpenzimet operative	47,958
3	Në shpenzimet për Investime	38,267,249
4	Të tjera	35,511,048
	Totali	74,490,878

Totali i efekteve negative në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit është 85,867,279 mijë lekë ose 694.1 milionë euro.



Institucionet ku janë ushtruar misionet e auditimit




Gjatë vitit 2020, auditimet kanë përfshirë vlerësimin e aktivitetit në 91 subjekte. Ato kanë përfshirë, institucione qendrore, ministri dhe agjenci (përfshirë drejtori qendrore dhe rajonale në varësi të tyre), njësi të vetëqeverisjes vendore (qarqe, bashki), drejtori të përgjithshme të administrimit fiskal, fonde speciale, si dhe shoqëri aksionare me kapital shtetëror, në të cilën shteti ka mbi 50% të aksioneve, apo projekte me financim të huaj. Në tabelën e mëposhtme është paraqitur shpërndarja e auditimeve sipas institucioneve.

Tabela nr.3 Institucionet ku janë ushtruar misionet e auditimit

Auditimet e KLSH-së janë ushtruar në këto institucione:	Nr
Institucione të qeverisjes qendrore	14
Institucionet e vetëqeverisjes vendore dhe njësi të tjera në nivel vendor	18
Institucione të tjera financiare, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe institucionet vartëse financiare	10
Shoqëri të publike dhe projektet me financim të huaj	9
Institucionet e administrimit të aseteve dhe mbrojtjes së mjedisit	8
Institucionet në të cilat janë kryer auditimet IT	4
Institucionet në të cilat janë kryer auditimet e Performances	28
TOTALI I SUBJEKTEVE	91

Grafik nr.1 Subjektet e audituara në periudhën Janar – Dhjetor 2020



Burimi KLSH

Trajtimi i Letrave të qytetarëve

Kontrolli i Lartë i Shtetit gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2020 ka vijuar të trajtojë me korrektesë dhe profesionalizëm letrat dhe ankesat e qytetarëve, të cilët në çdo rast kanë marrë përgjigje, edhe kur çështja e ngritur prej tyre ka qenë jashtë kompetencave të institucionit, duke i orientuar qytetarët, nëpërmjet përgjigjeve zyrtare se cilit institucion duhet ti drejtohen për të marrë përgjigje për shqetësimet e tyre.

Përgjatë kësaj periudhe KLSH ka trajtuar 301 letra dhe ankesa, nga të cilat 80 jashtë kompetencës dhe juridiksionit të institucionit. Nga 221 ankesa në kompetencë të KLSH, 136 prej tyre janë verifikuar dhe u është dhënë përgjigje, ndërsa 85 janë në proces verifikimi.


Trajtimi i kërkesave për të drejtën e informimit

E drejta e informimit si një e drejtë kushtetuese dhe tani e parashikuar qartazi në një legjislacion të veçantë, është e drejtë elementare e çdo individi në një shoqëri demokratike. Që me miratimin e ligji të ri nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Kontrolli i Lartë i Shtetit ka pasur një numër në rritje kërkesash për informacion nga viti në vit, të ardhura nga individë, subjekte të ndryshme dhe OJF. Vetëm gjatë periudhës janar – dhjetor 2020 janë trajtuar dhe u është përcjellë informacioni i kërkuar 38 kërkesave, të ardhura në adresën e koordinatorit të informimit të KLSH-së.

Në grafikun e mëposhtëm pasqyrohen fushat kryesore të shqetësimit publik për çështje të qeverisjes në Shqipëri, nga të cilat 9% e ankesave të adresuara KLSH-së i takojnë administrimit financiar dhe fushës së prokurimit publik; 3% në fushën e taksave,

tatimeve, 61% administrimit dhe kthimit të pronës dhe 16% fushave të tjera dhe 11% trajtojnë çështje të ndryshme.

Grafik nr. 2 Fushat kryesore të shqetësimit publik




Burimi KLSH

Rekomandimet sipas natyrës

Në institucionet e audituara, KLSH-ja gjatë periudhës janar – dhjetor 2020, ka adresuar gjithsej 1430 rekomandime, nga të cilat: 29 janë përmirësime ligjore, 1107 rekomandime organizative dhe 294 masa rekomandime disiplinore dhe administrative.

Grafik nr.3 Masat e rekomanduara nga KLSH për periudhën Janar - Dhjetor 2020



Burimi KLSH

Kallëzimet Penale

KLSH nga auditimet e realizuara për periudhën Janar – Dhjetor 2020 ka përcjellë prokurorisë 10 kallëzime dhe indicie penale.

Indicie për ndjekje penale	5
Vlerësim të dosjes nga Prokuroria	2
Kallëzim penal	1
Gjithsej	8 Indicie/Kallëzime penale
Persona të kallëzuar	10

Treguesit e dëmit ekonomik

Niveli i dëmit ekonomik dhe shpenzimeve joefektive apo me efekte negative (EEE) në buxhetin e shtetit në mënyrë të përmblodhur nga aktiviteti auditues përgjatë periudhës Janar – Dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

A. Parregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, me dëm ekonomik në shumën totale prej 2,193,692 mijë lekë ose 17,7 milionë euro.

Treguesi (Indikatori) i dobisë së auditimit për periudhën Janar – Dhjetor është 6,2

B. Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në shumën totale prej 85,867,279 mijë lekë, afërsisht nga e cila:

I. 11,376,401 mijë lekë në fushën e të ardhurave, afërsisht 91.9 milionë euro;

II. 74,490,878 mijë lekë afërsisht 602.2 milionë euro, në fushën e shpenzimeve jo me eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve si dhe shkelje të disiplinës buxhetore lidhur me likuidimin e shpenzimeve, keqmenaxhimin e fondeve të programuara apo mungesë kontrolli në realizimin e procedurave të prokurimit jo në përputhje me kuadrin ligjor.

Në total janë konstatuar shkelje në shumën 88,060,971 mijë lekë ose afërsisht 711.8 milionë euro.

**Kursi i këmbimit të lekut/euro është kursi i Bankës së Shqipërisë i datës 31.12.2020, 1 euro= 123.7 lekë.*

Këto shkelje financiare përgjithësisht i përkasin veprimtarisë ekonomiko-financiare për periudhën kohore 2018-2019 përcaktuar për çdo subjekt të audituar në programet e auditimit.

Treguesi i Dobishmërisë

Indikatori i dobisë së auditimit, i cili përdoret në kuadrin e matjes së performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit, për periudhën janar – dhjetor 2020 rezultoi 6.2, çka do të thotë se për çdo 1 (një) lek të shpenzuar për KLSH-në nga buxheti i shtetit për periudhën janar – dhjetor 2020, janë zbuluar nga auditimet e kryera 6,2 lekë dëme, për të cilat është kërkuar dhe arkëtimi i shumës. Treguesi i dobisë së auditimit është llogaritur si raporti i dëmeve të zbuluara dhe të kërkuara për zhdëmtim në vlerën 2,175,398 mijë lekë me shpenzimet buxhetore faktike të KLSH-së në vlerën 351,216 mijë lekë. Për vitin 2020 treguesi i dobishmërisë përfaqëson indikatorin e aplikuar vetëm mbi rezultatet e raporteve të evaduara, pa marrë parasysh elementet e pasqyruara për gjithë punën audituese të kryer në terren brenda vitit 2020, por të shtyrë për shkak të rrethanave të shkaktuara nga Covid-19.

II. SHKELJET ME DËM EKONOMIK


KLSH ka zbuluar parregullsi dhe shkelje financiare me pasojë dëm ekonomik në të ardhura dhe shpenzime, në shumën totale prej 2,193,692 mijë lekë, nga e cila ka rekomanduar për shpërblim dëmi shumën 2,175,398 mijë lekë.

Tabela nr.4

I	Dëmi ekonomik sipas fushave	000/Lekë
1	Nga shkeljet në zbatimin e legjislacionit tatimor	1,038,069
2	Nga shkeljet në zbatimin e kodit doganor	453,211
3	Nga keqadministrimi i pronës shtetërore të dhënë me qera, marrëveshjet hidrokarbure dhe kontrata koncesione	36,785
4	Të tjera	215,365
5	Në shpenzimet për paga, sigurime dhe shpërblime	96,205
6	Në shpenzimet operative	16,130
7	Në prokurime publike	337,927
	TOTALI I DËMEVE PËR VITIN 2020	2,193,692


Burimi KLSH

Grafik nr.4 Dëmi ekonomik sipas fushave në mijë lekë



Burimi KLSH

Grafik nr.5 Dëmi ekonomik sipas fushave në milionë lekë



Burimi KLSH

Parregullsi të dhe shkeljet financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, me dëm ekonomik, janë pasqyruar në mënyrë më të detajuar në formularin nr. 2, bashkëlidhur këtij Buletini Statistikor.

DËMI EKONOMIK


II.a) Në fushën e të ardhurave

Tabela nr.5 Dëmi ekonomik në fushën e të ardhurave

Dëm Ekonomik	000/lekë
Në fushën e tatim taksave	1,038,069
Në fushën e doganave	453,211
Në fushën e shitjes, blerjes dhe dhënies me qira të pasurisë shtetërore, marrëveshjeve hidrokarbure dhe kontratave koncesionare	36,785
Të tjera	190,052
Totali	1,718,117

Burimi KLSH

Grafik nr. 6 Dëmi ekonomik në të ardhura (në mijë lekë) për vitin 2020



Burimi KLSH

2.1 Në sektorin e Tatim – Taksave, në vlerën e përgjithshme prej 1,038,069 mijë lekë, konstatuar në institucionet:

Bashkia Rrogozhinë, në vlerën 190,021 mijë lekë, si pasojë e moszbatimit të procedurave për regjistrimin në kontabilitet të bizneseve debitore për periudhën para konsolidimit territorial, për taksat dhe tarifën e familjarëve, si dhe vlera nga asetet e dhëna me qira, nga të cilat:

- Vlera 26,631 mijë lekë është vlera e debisë për bizneset (detyrim+kamatë), nga e cila nuk është kontabilizuar detyrimi për vitin 2019;
- Vlera 23,891 mijë lekë është vlera debisë e pa kontabilizuar për 314 subjekte që kanë ushtruar aktivitet në periudhën 2011-2016.
- Vlera 99,599 mijë lekë është vlera e debisë e pa kontabilizuar për taksën e tokës;
- Vlera 38,929 mijë lekë, janë detyrime të pa paguara nga familjarët për taksën e tokës/tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit;
- Vlera 971 mijë lekë, janë detyrime të papaguara për asetet e dhëna me qira.

Bashkia Finiq, në vlerën 10,800 mijë lekë, si pasojë e mosllogaritjes sipas ligjit të tarifës për pajisjen me leje tregtimi të karburantit për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante.

Bashkia Malësi e Madhe, në vlerën 3,520 mijë lekë, si pasojë e mosndjekjes së rrugës ligjore për arkëtimin e penaliteteve të aplikuara për ndërtimet pa leje, masa të marra nga inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV). Gjithashtu këto gjopa, nuk janë kontabilizuar në librat e llogarive dhe kontabilitet si detyrime, pasi nga IMTV nuk janë përcjellë për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Rajonale – Agjencia Shtetërore e Kadastrës Sarandë, në vlerën 811,056 mijë lekë, si pasojë e mungesës së vërtetimeve mbi llogaritjen dhe pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 2312 objekte, për të cilat ka proceduar me vendim kualifikimi pa marrë konfirmimin mbi pagesën e saj.

Drejtoria Rajonale – Agjencia Shtetërore e Kadastrës Mirditë, në vlerën 14,915 mijë lekë, si pasojë e mosshlyerjes së detyrimeve financiare që rrjedhin nga miratimi i lejes së ndërtimit, lidhur me shlyerjen e detyrimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Drejtoria Rajonale – Agjencia Shtetërore e Kadastrës Mallakastër, në vlerën 7,648 mijë lekë, si pasojë e mosarkëtimin të taksës së ndikimit në infrastrukturë, e cila është e pa likuiduar dhe vlera e parcelës ndërtimore në pritje të VKM për 244 objekte.

Drejtoria Rajonale – Agjencia Shtetërore e Kadastrës Përmet, në vlerën 109 mijë lekë, si pasojë e mosarkëtimin të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

2.2 Në sektorin e Doganave, në vlerën e përgjithshme prej 453,211 mijë lekë, konstatuar në institucionet:

Dega e Doganës Durrës, në vlerën 453,211 mijë lekë, nga të cilat:

- Vlera 169,645 mijë lekë, si pasojë e mosshqyrtimit të thelluar të vlerës doganore sipas indikatorëve të përcaktuar, me qëllim standardizimin dhe unifikimin e

procedurave të shqyrtimit të vlerës së mallit për të evituar arbitraritetin, abuzivitetin dhe pabarazinë;

- Vlera 116,050 mijë lekë, si pasojë e konstatimit të diferencave progresive dhe 3-mujore të artikujve të importuar dhe të depozituar në Regjimin e Magazinave të Lira të "karburanteve", për subjektet të cilët kanë operuar në sektorin Porto Romano, ku për gjithë vitin ushtrimor rezulton në total 655688 litra lëndë djegëse, të cilave nuk u është dhënë destinacion doganor;
- Vlera 111,219 mijë lekë, si pasojë e mosrespektimit të afateve të qëndrimit të mallrave në regjimin e lejimit të përkohshëm dhe mallrave të importuara, të cilave nuk i'u është dhënë destinacion doganor nga subjektet përfitues të RLP, për të cilat nga sektori i regjimeve nuk është mbajtur procesverbal konstatimi për shkeljet e konstatuara;
- Vlera 28,119 mijë lekë, si pasojë e tejkalimit të afatit 30 ditor për mbylljen e regjimeve; shkelje të kufirit të rieksporit; importe të produkteve parësore të papërfshira në autorizim; dokumenti i mbylljes së regjimit ekonomik nuk rezulton të jetë miratuar nga kryetari i degës së doganës; grupim mallrash në kodin tarifor me nivel të taksës doganore më të ulët, si dhe diferenca materiale në produktet kompensuese;
- Vlera 15,327 mijë lekë, si pasojë e vendimeve administrative për shkeljet në fushën doganore të nxjerra jo në përputhje me kërkesat e nenit 261 të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Vlera 12,500 mijë lekë, rezultojnë veprime jo në përputhje me kërkesat e nenit 126.1/a të Kodit Doganor, të cilat u evidentuan pas shqyrtimit të dokumentacionit të praktikave doganore të operatorëve që kanë operuar nën mbikqyrjen doganore në regjimin e tranzitit (T1), ku nuk është respektuar afati i caktuar kohor për mbërritje në doganën e destinacionit;
- Vlera 350 mijë lekë, si pasojë e moskryerjes së kalibrimeve për të gjitha depozitat e silloset me kapacitet mbajtës mbi 10 hektolitra si dhe mos disponimit të kalimatësave në hyrje dhe dalje të produktit në depozita si dhe në pikën e shitjes.

2.3 Në fushën e shitjes, blerjes dhe dhënies me qira të pasurisë shtetërore, marrëveshjeve hidrokarbure dhe kontratave koncensionare në shumën e përgjithshme prej 36,785 mijë lekë.

Administrimi i pronës publike është një koncept mjaft i gjerë. Në mënyrë të përmbledhur sjellim gjetjet më të rëndësishme lidhur me administrimin e pronës.

Bashkia Ura Vajgurore, në vlerën 36,652 mijë lekë, si pasojë e moslidhjes së kontratave të qirave për shfrytëzimin e 35 ha sipërfaqe pyjore/kullosore për 17 subjekte, kontrata e qirasë është lidhur për sipërfaqen 16.2 ha. Për këto sipërfaqe nga Sektori i Pyjeve dhe Mbrojtjes Mjedisit nuk janë zbatuar procedurat e pakësimi të sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor.

Porti Detar Vlorë SHA, në vlerën 133 mijë lekë, si pasojë e mosarkëtimit të shumës për vendosjen në ambientet e terminalit të ri të 2 tabelave reklame nga subjekti privat, lidhur me këtë rast disponohet një kontratë sponsorizimi e lidhur midis palëve.

2.4 Në fushën Të Tjera, në shumën e përgjithshme prej 190,052 mijë lekë.

Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, në vlerën 151 mijë lekë, si pasojë e mosvlerësimit për aktivet e identifikuar si të papërdorshme nga komisioni i inventarizimit të vitit 2017 dhe të asgjësuar/tjetërsuara në vitin 2018, si dhe nuk është hartuar procesverbal vlerësimi.

Drejtoria Rajonale – Agjencia Shtetërore e Kadastrës Sarandë, në vlerën 138,870 mijë lekë, si pasojë e mosndjekjes së të gjitha procedurave për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore deri në daljen e VKM-së për 2035 dosje të objekteve informale të pajisur me leje legalizimi të objektit, për të mundësuar brenda afateve ligjore likuidimin e vleftës përkatëse të parcelave ndërtimore.

Drejtoria Rajonale – Agjencia Shtetërore e Kadastrës Mallakastër, në vlerën 15,536 mijë lekë, si pasojë e moslikuidimit të vlerës së parcelës ndërtimore dhe mos marrjes së masave për ndjekjen e ecurisë së procesit për daljen e VKM-së për kalimin e pronësisë dhe shpronësimin e ish-pronarëve përkatës.

Drejtoria Rajonale – Agjencia Shtetërore e Kadastrës Mirditë, në vlerën 8,506 mijë lekë, si pasojë e moslikuidimit të vlerës së parcelës ndërtimore.

Drejtoria Rajonale – Agjencia Shtetërore e Kadastrës Përmet, në vlerën 1,713 mijë lekë, si pasojë moslogaritjes dhe arkëtimit të kamatë vonesës për regjistrimin me vonesë të aktit administrativ.

Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe DRISHMPUT Lezhë, në vlerën 4,982 mijë lekë, si pasojë e mosarkëtimit të gjobave të vendosura për lejet mjedisore si dhe tarifave për zhvillimin e vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Ish-Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe Ish-DRISHMPUT Vlorë (aktualisht Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier), në vlerën 1,136 mijë lekë, si pasojë e mosarkëtimit të gjobave të vendosura për lejet mjedisore si dhe tarifave për zhvillimin e vlerësimit të ndikimit në mjedis.


II.b) Në fushën e shpenzimeve

Tabela nr.6 Përmbledhja e shkeljeve me pasojë dëm ekonomik në fushën e shpenzimeve

Dëm Ekonomik	000/lekë
Në Shpenzimet për paga, Sigurime dhe Shpërblime	96,205
Në Shpenzimet Operative	16,130
Në Shpenzimet për Investime	337,927
Të tjera	25,313
Totali	475,575

Burimi KLSH

Grafik nr. 7 Dëmi ekonomik në shpenzime (në mijë lekë) për vitin 2020



Burimi KLSH

2.1 Në fushën e pagave, shpërblimeve dhe sigurimeve shoqërore, në vlerën e përgjithshme prej 96,205 mijë lekë, konstatuar në institucionet:

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në vlerën 1,662 mijë lekë, nga të cilat:

- 1,552 mijë lekë, si pasojë e pagesave në pagë grupi jo në përputhje me nivelin e diplomës, konstatuar për 14 (katërbëdhjetë) punonjës.
- 110 mijë lekë, si pasojë e pagesës së dietave për shërbimet e kryera mbi 100 km jashtë qendrës së punës pa marrë më parë autorizimin nga titullari i Institucionit.

Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, në vlerën 515 mijë lekë, si pasojë e pagesave me pagë grupi, e cila është jo në përputhje me nivelin e diplomës, konstatuar për 3 (tre) punonjës.

Bashkia Malësi e Madhe, në vlerën 564 mijë lekë, si pasojë e pagave të paguara padrejtësisht për 4 (katër) punonjës për periudhën e viteve 2018-2019-2020 mbi strukturën e pagave, ku janë emëruar punonjës jo me arsimin e duhur.

Ujësjiellës Kanalizimeve Kavajë SHA, në vlerën 92,984 mijë lekë, të ardhur si pasojë e punësimeve mbi strukturë, pra tejkallim të strukturës së shoqërisë (150 punonjës mbi strukturë) nga ajo e miratuar me vendim të Këshillit Administrativ. Kjo periudhë përfshin muajt tetor, nëntor, dhjetor, 2019, ku numri total i punonjësve ka arritur mbi 315 punonjës nga 152 punonjës që ka në strukturë e miratuar.

Porti Detar Shëngjin SHA, në vlerën 116 mijë lekë, si pasojë e përfitimit padrejtësisht të shpërblimit nga 1 (një) nga anëtarët e Këshillit, i cili ka munguar më shumë se 3 mbledhje radhazi.


Ish-Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe Ish-DRISHMPUT Vlorë (aktualisht Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier), në vlerën 364 mijë lekë, si pasojë e gjobave të vendosura

për likuidim me vonesë të sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore si dhe likuidim për vendimet e dhëna nga Komisioni i Shërbimit Civil.

2.2 Dëmi ekonomik i rezultuar në fushën e prokurimit të nevojave për mallra/shërbime/investime publike, kap vlerën e përgjithshme 337,927 mijë lekë. Dëmi është konstatuar si në fazën e zhvillimit të procedurave të prokurimit, ashtu edhe në fazën e zbatimit të kontratave dhe dorëzimit të punimeve

Problematikat e konstatuara nga auditimet lidhen jo vetëm me planifikim jo të drejtë të nevojave por edhe një proces të realizuar jo në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. Mangësitë i referohen implementimit jo të saktë të kërkesave dhe detyrimeve ligjore nga entet publike që prokurojnë fondet përmes sistemit të prokurimit publik, fakt që lidhet edhe me kapacitetet njerëzore jo gjithmonë profesionale, që përfshihen në realizimin e këtij procesi. Dëmi ekonomik në fushën e prokurimeve publike konstatohet si shkelje në: përgatitjen e dokumentacionit të tenderit, hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të vlerësimit; llogaritjen e vlerës së kontratës; respektimin e kufijve monetar/përzgjedhjen e procedurës së prokurimit publik; paraqitjen dhe pranimin e ofertave; hapjen dhe shqyrtimin e ofertave të paraqitura në konkurim; në njoftimin e fituesit, në procedurat e prokurimit me një ofertues, në lidhjen e kontratave dhe marrëdhëniet me nënkontraktorët, arkivimin e dosjeve për tenderat e zhvilluar; zbatimin e kontratave nga kontraktorët në përputhje me kushtet e përgjithshme etj. Në total, për vitin 2020, vetëm nga auditimi i procedurave të prokurimit ka një dëm ekonomik në shumën 337,927 mijë lekë nga të cilat vlera 270,649 mijë lekë në procedurë prokurimi dhe vlera 67,278 mijë lekë gjatë zbatimit të kontratave dhe dorëzimit të punimeve.


Grafik nr.8: Dëmi ekonomik në fushën e prokurimeve në %



Burimi KLSH

Duke ju referuar grafikut nr.9 konstatohet se shkeljet dhe problematikat në lidhje me procedurat e prokurimit më të mëdha vërehen në auditimin e ushtruar në Agjencinë e Blerjeve të Përqëndruara (ABP) me vlerë 209,677 mijë lekë. Rezultojnë problematika në hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, me mos përgatitjen dhe hartimin e një pakete për unifikimin e kritereve të veçanta të kualifikimit, për një pjesë të konsiderueshme të fondeve buxhetore nuk është arritur efienca dhe efektiviteti.

Grafiku nr. 9 Dëmi ekonomik i konstatuar në fazën e zhvillimit të procedurës së prokurimit në Agjencinë e Blerjeve të Përqëndruara



Burimi KLSH

2.2.1 Shkelje në realizimin e procedurave të prokurimit

Shkeljet në procedurat e prokurimit vetëm në 9 subjekte, kanë sjellë një dëm ekonomik në buxhetin e shtetit në masën 270,649 mijë lekë. Shkeljet kanë rezultuar në plotësimin e kriterëve të kualifikimit, në skualifikimet e ofertuesve, në hapjen e shqyrtimin e ofertave, në ofertat anomalisht të ulta dhe zhvillohen procedura prokurimi me një pjesëmarrës dhe fitues njëkohësisht.

Tabela nr. 8 Dëmi ekonomik i konstatuar në realizimin e procedurave të prokurimit

Subjektet e audituara	Vlera (në mijë lekë)
Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara	209,677
Bashkia Finiq	41,917
Bashkia Divjakë	13,222
Bashkia Ura Vajgurore	2,107
Shërbimi Kombëtar i Punësimit	1,396
Porti Detar Shëngjin SHA	813
Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore	801
Instituti i Monumenteve të Kulturës	622
Projekti: Zhvillimi i sektorit privat, Ministria e Financave dhe Ekonomisë	468
Ujësjiellës Kanalizime Kavajë SHA	94
Totali (në mijë lekë)	270,649

Burimi KLSH

2.2.2 Shkelje në zbatimin e punimeve, në institucionet si më poshtë:

Shkeljet në zbatimin e kontratave për 9 subjekte, kanë sjellë dëm ekonomik në buxhetin e shtetit në masën 67,278 mijë lekë. Shkeljet e këtij grupimi fillojnë me problemet në lidhjen e kontratave, aktet e marrjes në dorëzim, në mungesa apo problematika në kryerjen e punimeve të ndërtimit, inventarizim dosjesh etj.

Tabela nr.9 Dëmi ekonomik i konstatuar në zbatimin e punimeve

Subjektet e audituara	Vlera (në mijë lekë)
Shërbimi Kombëtar i Punësimit	29,844
Bashkia Finiq	21,647
Porti Detar Vlorë SHA	3,774
Bashkia Ura Vajgurore	3,403
Bashkia Skrapar	3,118
Bashkia Divjakë	2,511
Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, Bashkia Tiranë	1,450
Bashkia Malësi e Madhe	988
Instituti i Monumenteve të Kulturës	75
Totali (në mijë lekë)	67,278

Burimi KLSH

2.3 Në fushën e shpenzimeve operative, në vlerën e përgjithshme prej 16,130 mijë lekë, konstatuar në institucionet:

Tabela nr. 10

Subjektet e audituara	Vlera (në mijë lekë)
Ujësjetës Kanalizime Kavajë SHA	8,183
Bashkia Skrapar	2,178
Shërbimi Kombëtar i Punësimit	2,041
Rezidenca Studentore nr.2 SHA Tiranë	1,194
Bashkia Finiq	1,728
Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër	778
Porti Detar Vlorë SHA	28
Totali (në mijë lekë)	16,130

2.4 Në fushën Të Tjera, në shumën e përgjithshme prej 25,313 mijë lekë

Bashkia Cërrik, në vlerën 9,789 mijë lekë, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera ndaj operatorëve ekonomik.

Bashkia Malësi e Madhe, në vlerën 9,500 mijë lekë, si pasojë e mospajisjes me autorizim/licenca të subjekteve që kryejnë tregti me pakicë të karburantëve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë.


Bashkia Finiq, në vlerën 1,292 mijë lekë, si pasojë e mosmungesës së dokumentacionit (hyrje/dalje dhe gjëndje) për konsumimin e karburantit në vitet 2017-2019.

Projekti: Zhvillimi i Sektorit Privat, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në vlerën 4,732 mijë lekë, si pasojë e mosaplikimit të penaliteteve për mangësitë e konstatuara përgjatë dosjeve të kredive të dhëna ndaj subjekteve kredimarrëse.

III. SHKELJE TË DISIPLINËS FINANCIARE ME NDIKIM NEGATIV NË PERFORMANCËN E ADMINISTRIMIT TË TË ARDHURAVE DHE NË PËRDORIMIN E FONDEVE PUBLIKE PËR SUBJEKTET E AUDITUARA

Kontrolli i Lartë i Shtetit, gjatë vitit 2020, ka evidentuar shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e administrimit të të ardhurave dhe në përdorimin e fondeve publike në vlerën totale 85,867,279 mijë lekë nga të cilat: 11,376,401 mijë lekë në fushën e të ardhurave dhe 74,490,878 mijë lekë në fushën e shpenzimeve jo me eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve, si dhe shkelje të disiplinës buxhetore lidhur me likuidimin e shpenzimeve, keqmenaxhimin e fondeve të programuara apo mungesë kontrolli në realizimin e procedurave të prokurimit jo në përputhje me kuadrin ligjor. Në grafikun e mëposhtëm ilustrohen shkeljet e disiplinës financiare në fushën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Grafik nr.10 Shkelje të disiplinës financiare në fushën e të ardhurave dhe shpenzimeve në mijë lekë




Burimi KLSH

Shkeljet e disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, janë pasqyruar në mënyrë më të detajuar në formularin nr. 3, bashkëlidhur këtij Buletini Statistikor.

III.1 Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në administrimin e të ardhurave

Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e administrimit të të ardhurave për subjektet e audituara, arrin vlerën 11,376,401 mijë lekë.

Grafik nr. 12: Shkelje të disiplinës financiare në fushën e të ardhurave (mijë lekë)



Burimi KLSH

Efektet negative të lidhura me administrimin e sistemit tatimor & doganor, nga qiratë & privatizimit, koncensionet, Urbanistikës dhe në fushën të tjera

Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Publik, në vlerën 8,695,000 mijë lekë, si pasojë e krijimit të detyrimeve të reja në shumën 6,065 milion lekë të subjekteve nënhuamarrëse dhe janë krijuar detyrime të reja të lidhura me garancitë shtetërore në shumën 2,630 milion lekë.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në vlerën 1,487,753 mijë lekë, si pasojë e rritjes vjetore të borxhit tatimor në lidhje me tatim fitimin.

Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, në vlerën 3,711 mijë lekë, si pasojë e kamat vonesave për likuidimin e qerasë në kundërshtim me nenin 4, pika 1 dhe 3 të kontratave tip me subjekte vendase.

Bashkia Ura Vajgurore, në vlerën 246,729 mijë lekë, nga të cilat:

- Vlera 223,114 mijë lekë, si pasojë e mospagesës së taksës së tokës me tarifat përkatëse, 7531 familje në shumën 166,711 mijë lekë, taksa lokale me tarifat përkatëse, 909 familje në shumën 9,010 mijë lekë, si dhe 210 familje për qiranë e tokës bujqësore në vlerën 12,228 mijë lekë të cilët rezultojnë debitorë me datë 31.12.2019. Për vitin 2019, nuk kanë paguar taksë ndërtesë, pastrimi, ndriçimi e gjelbërimi 5439 familje në shumën 13,001 mijë lekë, të cilët rezultojnë debitorë me datë 31.12.2019. Nga subjekte të biznesit të vogël dhe të madh për të cilat janë planifikuar të ardhura për taksa e tarifa vendore pavarësisht punës së bërë niveli i arkëtimit është shumë i ulët, kanë mbetur pa u arkëtuar 13,542 mijë lekë. Gjithashtu nuk janë arkëtuar gjobat e vendosura nga Inspektorati i Mbrojtjes Territorit Vendor për periudhën deri 31.12.2019 në vlerën 2,020 mijë lekë. Gjatë auditimit të taksave/tarifave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, janë konstatuar mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti duke mos u paguar detyrimet për pajisje me licence tregtimi në përputhje me bazën ligjore në vlerën 6,600 mijë lekë.

- Vlera 23,615 mijë lekë, si pasojë e mosarkëtimit të detyrimeve tatimore nga 95 subjekte të biznesit të vogël, 23 të biznesit të madh, të cilët nga të dhënat e zyrës së financës janë kontabilizuar.

Bashkia Rrogozhinë, në vlerën 221,658 mijë lekë, si pasojë e moszbatimit të procedurave për regjistrimin në kontabilitet dhe mos marrjen e masave nga sektori i të ardhurave për arkëtimin e detyrimeve debitoare (188 biznese të vogla dhe 34 biznese të mëdha), për periudhën para konsolidimit territorial, për taksat dhe tarifatat e familjarëve, si dhe vlera nga asetet e dhëna me qira.

Bashkia Finiq, në vlerën 161,232 mijë lekë, nga të cilat:

- Vlera 131,649 mijë lekë, si pasojë e mosarkëtimit të detyrimeve të prapambetura (borxhi tatimor) për 204 subjekte fizik/juridik për taksat e pasurisë së tokës, ndërtesës, hapësirave publike, tarifave vendore dhe 4539 abonentët familjarë për taksën e pasurisë dhe tarifatat vendore;
- Vlera 29,583 mijë lekë, si pasojë e lidhjes së kontratës në kundërshtim me bazën ligjore për dhënien me qira për 30 vjet të sipërfaqeve të fondit pyjor e kullësor, kur së pari toka e dhënë me qira nuk është kategorizuar në zërin " tokë me bimësi pyjore djerr" dhe kur qëllimi i përdorimit është për mbarështimin e faunës dhe florës.

Bashkia Malësi e Madhe, në vlerën 141,083 mijë lekë, nga të cilat:

- Vlera 113,743 mijë lekë, si pasojë e mosarkëtimit të detyrimeve të prapambetura (borxhi tatimor) për 11420 subjekte. Në fund të periudhës 31.12.2019, gjendja e debitorëve për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë është:
 - a) 211 subjekte fizik/juridik me vlerë 26,652 mijë lekë për taksat pasurisë, tokës, ndërtesës, hapësirave publike dhe tarifave vendore.
 - b) 11209 abonentët familjarë me vlerë 87,091 mijë lekë, për taksën e pasurisë dhe tarifatat vendore, nga e cila: taksa tokë bujqësore në shumën 3,653 mijë lekë, taksë ndërtesë në vlerën 16,763 mijë lekë dhe tarifa shërbimi në vlerën 64,505 mijë lekë. Vlera e debitorëve abonentëve familjarë është 76.5 % e vlerës së gjithë borxhit fiskal.
- Vlera 13,287 mijë lekë, si pasojë e mos zbatimit të kushteve të kontratave lidhur midis bashkisë Malësi e Madhe (ish Komuna Shkrel) me subjektin "M.S" për dhënien me qira të sipërfaqes prej 15 ha për një kohë rreth 30 vite.
- Vlera 8,128 mijë lekë, si pasojë e mos arkëtimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë
- Vlera 5,925 mijë lekë, si pasojë e mosmenaxhimit për lirim ose lidhjen e kontratave të qirasë së objekteve në pronësi të bashkisë të uzurpuar nga të tretë.

Bashkia Roskovec në vlerën 111,865 mijë lekë, si pasojë e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore nga të cilat 14,030 mijë lekë detyrim i taksapaguesve privat dhe 97,835 mijë lekë detyrim i taksapaguesve familjar.

Bashkia Skrapar në vlerën 89,263 mijë lekë, si pasojë e mos marrjes së masave nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, në fund të vitit 2019 janë krijuar debitorë të subjekteve fizik/juridik dhe debitorë familjarë për taksat dhe tarifa vendore dhe gjithashtu debitorë të konstatuar nga kontrolle të ndryshme para datës 31.12.2016 të bashkisë Çorovodë dhe 8 (tetë) njësitë administrative.

Prefekti i Qarkut Tiranë, në vlerën 67,707 mijë lekë, veprim në papajtueshmëri me Ligjin nr.7501, datë 19.07.1991 "Për tokën" të ndryshuar. Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë për 38 raste nuk kanë kërkuar në rrugë ligjore dhe administrative nga mbajtësi i parë i titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore të përfituar në kundërshtim me ligjin.

Bashkia Divjakë, në vlerën 12,325 mijë lekë, nga të cilët:

- Vlera 6,367 mijë lekë, si pasojë mos arkëtimit të qirasë nga subjekte të ndryshme (debitorë) për dhënien e aseteve në pronësi të bashkisë.
- Vlera 5,958 mijë lekë, si pasojë e mos zbatimit të VKM Nr.860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", pika 5, si dhe ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave vendore", i ndryshuar, pika 3 e nenit 27 - Taksa e ndikimit në infrastrukturë, për objektet që legalizohen. Rezulton se nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, Bashkia Tiranë, 45,326 mijë lekë, nga të cilat:

- Vlera 25,206 mijë lekë, si pasojë e mos lidhjes së kontratave të qirasë dhe mos llogaritja e detyrimit për sipërfaqet që përdoren nga individë dhe subjekte, të evidentuara në 188 ngastra me një sipërfaqe totale prej 692 ha;
- Vlera 20,119 mijë lekë, si pasojë e mos arkëtimit për likuidimin e vlerës së kontratave të qirasë për 110 kontratat me objekt "Dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor".

Porti Detar Shëngjin SHA, në vlerën 2,431 mijë lekë, si pasojë e mospërputhjeve midis emërimit të pozicionit të punës të shënuar në kontratën e punës dhe atij të shënuar në listëprezencë, listëpagesë dhe në sistemin tatimor dhe gjithashtu dublim të pozicioneve të punës.

Porti Detar Vlorë SHA, në vlerën 195-mijë lekë, si pasojë e favorizimit padrejtësisht subjektin qiramarrës nëpërmjet lidhjes së kontratës me mangësi në dokumentacion, duke lidhur kontratë pa ngurtësuar më parë sigurimin e kontratës si dhe duke lejuar lidhjen e një kontrate të re pa respektuar afatin për ndërprerje të kontratës së parë.

Ish-Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe Ish-DRISHMPUT Vlorë (aktualisht Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier), në vlerë 90,123 mijë lekë nga të cilat:

- Vlera 68,040 mijë lekë, si pasojë e mos marrjes së masave administrative gjobë për 362 subjekte të inspektuara përgjatë vitit 2019 në vlerën 57,600 mijë lekë dhe mos vendosje penaliteti ndaj subjekteve të cilat kanë hedhur mbetje në 337 ambiente të pa përcaktuara nga bashkitë e Qarkut Vlorë, Fier dhe Gjirokastër në vlerën 11,110 mijë lekë;


- Vlera 18,423 mijë lekë, si pasojë e mos arkëtimit të detyrimeve nga vendosja e 54 masave administrative "Gjoha" në 319 inspektime të kryera për periudhën 2018-2019;
- Vlera 3,660 mijë lekë, si pasojë e mos pajisjes me leje mjedisore, kryesisht të tipit B dhe C për subjektet aktive deri më 31.12.2018, gjithsej për 222 subjekte.

III.2 Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e përdorimit të fondeve publike nga subjektet e audituara.

Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në shpenzimin e fondeve në dispozicion, arrin vlerën 74,490,878 mijë lekë.

Shkeljet e disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në shpenzimin e fondeve kanë rezultuar në fushën e pagave dhe shpërblimeve, në fushën e keqmenaxhimit të fondeve të programuara për shpenzime operative, në fushën e prokurimit të fondeve publike dhe realizimin e procedurave të prokurimit jo në përputhje me kuadrin ligjor.

Grafik nr.13: Shkelje të disiplinës financiare në fushën e shpenzimeve



Burimi KLSH

Efekte financiare në fushën e pagave dhe shpërblimeve

Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, në vlerën 24,978 mijë lekë, si pasojë e parregullsive në 12 procedua rekrutimi, që përfshin të gjitha nivelet menaxheriale duke shkaktuar shpenzim në kushtet e paligjshmërisë për vitet 2016-2019.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në vlerën 598,915 mijë lekë, si pasojë pagesave për shpenzimet gjyqësore për ish punonjësve gjatë vitit 2019. Duke marr në konsideratë faktin që për të njëjtin vend pune paguhen 2 persona, ish punonjësi që ka fituar gjyqin për largim të padrejtë nga puna dhe punonjësi i ri i rekrutuar, kjo situatë paraqitet edhe më problematike dhe me efekte të konsiderueshme në buxhet. Detyrimi i prapambetur në 31.12.2019 për shpenzime të gjyq fitueseve me vendim të formës së prerë për largime të padrejta nga puna.

Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, në vlerën 26,300 mijë lekë, si pasojë e shpenzimeve në fond page dhe kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën Janar 2019 - Gusht 2020 nga institucioni për 18 punonjësit pjesë e "Sektorit të Laboratorit të Kontrollit". Referuar të dhënave të këtij sektori për një mbi numrin e analizave të kryera nga institucioni gjatë një periudhë disa vjeçare, rezultoi se, nga 498 analiza të kryera në vitin 2014, numri i tyre në vitin 2018 ka arritur në 169 të tilla me një tkurrje të konsiderueshme me rreth 60% të tyre. Ndërkohë për vitin 2019 regjistrohen vetëm 68 analiza ose rreth 13.6% e analizave të realizuara në vitin 2014, pra me një numër mjaft të vogël analizash krahasuar me periudhat e sipërpërmendura. Analiza e fundit në këtë sektor regjistrohet në muajin Tetor 2019 por më pas institucioni nuk ka vijuar kryerjen e tyre dhe puna e sektorit në këtë drejtim bazë është ndërprerë tërësisht. Në vijim, punonjësit janë ngarkuar me detyra plotësuese mbi përgatitje materialesh mbi procesin e akreditimit, i cili pavarësisht vlerës së shtuar që sjell, nuk justifikon moskryerjen e analizave mbi barnat, që është objekti kryesor i punës së veprimtarisë së sektorit.

Porti Detar Shëngjin SHA, në vlerën 5,092 mijë lekë, si pasojë e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës për 23 punonjës të shoqërisë. Largimet e punonjësve, si dhe mos ndjekjen e procedurave ligjore në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës nga ish titullari si dhe nga Këshilli Mbikëqyrës.

Porti Detar Vlorë SHA, në vlerën 5,078 mijë lekë, si pasojë e mosndjekjes së procedurave ligjore në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ish punonjësit. Shoqëria është paditur nga 11 persona, nga të cilët 4 çështje janë në proces gjyqimor dhe 7 procedura kanë përfunduar duke e detyruar Portin Vlorë të paguajë dëmshpërblimin dhe shpenzimet gjyqësore.

Rezidenca Studentore nr.2 Tiranë SHA, në vlerën 4,260 mijë lekë, si pasojë e ndryshimeve të shpeshta të strukturës duke suprimuar vëndet e punës për 24 punonjës, miratuar me Vendimin nr.63, datë 17.11.2017 dhe Nr.76, datë 27.04.2018 të Këshillit Mbikëqyrës. Nga punonjësit e larguar nga puna rezultoi se janë ngritur padi në organet gjyqësore për largim të padrejtë nga puna dhe nga auditimi i dokumentacionit për shpenzime për vendime gjyqësore dhe shpenzime përmbartimore.

Efekte financiare nga keqmenaxhimi i fondeve të programuara për shpenzime operative, lidhur me shkeljet ligjore me marrjen e angazhimeve deri në mungesën e kontrolleve për të mbajtur kostot buxhetore në nivelin e programuar, apo shkelje të tjera të disiplinës buxhetore lidhur me likuidimin e shpenzimeve

Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, në vlerën 9,046 mijë lekë, si pasojë e shpenzimeve për udhëtime dhe dieta në kushtet e paligjshmërisë për vitin 2018-2019. Në 130 raste ose 95% të rasteve, janë kryer shpenzime për udhëtime e dieta, të pambështetur me dokumentacionin vërtetues për kryerjen e detyrës.

Instituti i Monumenteve të Kulturës, në vlerën 7,011 mijë lekë, nga të cilat:

- Vlera 6,651 mijë lekë, si pasojë e pagesave për vendime gjyqësore për largim të padrejtë nga puna, të cilat thuajse në të gjitha rastet janë fituar nga punonjësit.

- Vlera 360 mijë lekë, janë paguar shpenzime për mirëmbajtje të sistemeve informatikë WEB GIS, sistem i cili përdoret për inventarizim dhe paraqitjen në hartë të monumenteve të kulturës.

Drejtorja e Shërbimit të Trupit Diplomatik, në vlerën 760 mijë lekë, si pasojë e mosmenaxhimit të fondeve për shpenzimin e "Udhëtimit turistik" jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Bashkia Malësi e Madhe, në vlerën 12,005 mijë lekë, si pasojë e pagesave të kryera në artikullin 602, financime në formë Sponsorizime ekipin e futbollit, i cili ka statusin "Shoqatë", duke financuar për dieta, trajtim ushqimorë, shërbim transporti, nga të cilat në vitin 2018 në shumën 4,566 mijë lekë dhe në vitin 2019 në shumën 7,438 mijë lekë.

Bashkia Skrapar, në vlerën 8,121 mijë lekë, si rezultat i moslikuidimit në kohë të detyrimeve për energjinë elektrike nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike për periudhën dy vjeçare 2010-2011, për 17 kontrata të energjisë elektrike për ndriçimin rrugor, në datën 29.06.2018 midis Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike dhe OSHEE është nënshkruar akt-marrëveshje për shlyerjen me këste të detyrimit të konstatuar në vlerën 12,942,139 lekë, me vlerë të këstit mujor 171,257 lekë, nga e cila principal 84,950 lekë dhe 86,308 lekë kamat-vonesë. Për periudhën 18 mujore (korrik 2018-dhjetor 2019), vlera e kamatë vonesës së paguar është 1,553,544 lekë, e cila është shpenzim i kryer jo për mall, punë apo shërbim, por për mos përmbushje në kohë të detyrimeve nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqëvisjes Vendore (AMVV), në vlerën 3,338 mijë lekë, janë kryer shpenzime për seminare, për veprimtari të ndryshme të organizuara për seminare, fonde të akorduara nga buxheti në artikullin 602/9009 "Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca e seminare për pritje përcjellje" pa ju nënshtruar procedurës së prokurimit publik në 9 raste për vitin 2017-2018.

Bashkia Finiq, në vlerën 1,233 mijë lekë, si pasojë e pagesave të kryera pa u miratuar me vendim nga Këshilli i Bashkisë për shpenzime transporti urban dhe shpenzime karburant gjithsej 7044 litra.

Porti Detar Vlorë SHA, në vlerën 813 mijë lekë, si pasojë e shpenzimeve (*Në kartelat përkatëse të mjeteve, në të cilat regjistrohen të gjitha të dhënat e automjetit si dhe shpenzimet që do të kryhen për to*) që janë kryer për automjetet e shoqërisë, në të cilat nuk kanë evidentuar kilometrazhin në fillim të vitit dhe në fund të vitit për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për goma, filtra e vaj, karburant, riparime etj. Këto shpenzime nuk mund të përlllogariten pa pasqyruar elementin bazë i cili është kilometrazhi, për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e tyre.

Projekti: Zhvillimi i Sektorit Privat në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në vlerën 594 mijë lekë, si pasojë e mosmarrjes së masave për evidentimin e mangësive dhe më pas kthimin pas të shumës së mbajtur nga kreditë e dhëna për shkak të mangësive të theksuara në dokumentacion.

Efekte negative të lidhura me mungesa kontrolli nga strukturat shtetërore gjatë prokurimit të fondeve publike dhe realizim të procedurave të prokurimit jo në përputhje me kuadrin ligjor

Nga auditimet e realizuar janë konstatuar problematika të cilat lidhen me mungesën e sistemeve të kontrollit nga strukturat përgjegjëse të prokurimeve, shoqëruar me paligjshmëri të proceseve të prokurimit të fondeve publike, duke ulur efekshmërinë e qëllimit kryesor të ligjit për prokurimet publike, pra atë të sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar.

Po ti referohemi efekteve negative në fushën e prokurimeve të evidentuara në 73 misioneve të auditimit të realizuara përgjatë periudhës janar – dhjetor 2020, rezulton se 19 subjektet e mëposhtme zënë rreth 51.3% të vlerës së përdorimit jo me efektivitet të fondeve të prokuruar si dhe rreth 44 % të vlerës totale të evidentuar në shkeljet e disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në shpenzimin e fondeve në dispozicion.

Në tabelën më poshtë kemi grupuar problematikat me një shtrirje dhe shpërndarje thuaj uniforme në strukturat e audituara.

Tabela nr. 11

Subjektet me efekte negative në fushën e prokurimeve	Vlera në mijë lekë
MFE: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit	29,513,723
MFE: Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit	7,454,116
Bashkia Ura Vajguore	343,492
Agjencia e Blerjeve të Përqendruara (ABP)	210,052
Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit	187,755
Bashkia Finiq	138,142
Bashkia Malësi e Madhe	118,639
Projekti: Bulevardi verior dhe rehabilitimi i lumit të Tiranës	110,187
Banka e Shqipërisë	108,874
Ministria e Kulturës	45,700
Prefekti i Qarkut Tiranë	14,399
MFE: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	10,499
Ujësjellës Kanalizime Kavajë SHA	4,307
Bashkia Divjakë	2,123
Instituti i Monumenteve të Kulturës	1,394
Bashkia Skrapar	1,248
Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër	1,205
Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik	480
Rezidenca Studentore nr.2 Tiranë SHA	914

Burimi KLSH

Problematikat janë konstatuar në institucionet:

Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, në vlerën 1,205 mijë lekë, si pasojë e mos zbatimit të gjurmës së auditimit për procedurat e prokurimit me qëllim përdorimin me eficiencë, efektivitete dhe ekonomikitet të fondeve buxhetore.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, në vlerën 29,513,723 mijë lekë, nga të cilat:

- 907,3 milion lekë, si pasojë e tejkalimit të planit të buxhetit për shtatë projekte investimi kapitale me financim të huaj.
- 679,7 milion lekë, konstatohet se në të dhënat SIFQ ekziston një numër i madh projektesh, të cilët sipas detajimit të fondeve buxhetore janë planifikuar në zërin 231 "Investime Kapitale të Trupëzuara", ndërkohë raportimi i tyre në SIFQ është bërë në zërin 230 "Investime Kapitale të Pa Trupëzuara" pa pasur plan buxheti.
- 565,6 milion lekë, si pasojë se në mbyllje të periudhës ushtrimore 2019, 12 projekte Investimi kanë përshkrimin "Fond i ngrirë", veprime në kundërshtim me Ligjin Nr.9936, datë, 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
- 285,4 milion lekë, si pasojë e realizimit të Investimeve Kapitale me Financim të Brendshëm nga të ardhurat dytësore, pra investime të cilat nuk kanë plan buxheti të miratuar me Ligj, por që në tabelën e treguesve fiskal të konsoliduar realizimi i tyre konsiderohet si një realizim ndaj planit të buxhetit.
- 180,2 milion lekë, si pasojë e tejkalimit të planit të buxhetit për shtatë projekte investimi kapitale me financim të huaj.
- 119,5 milion lekë, si pasojë e kontabilizimit në mënyrë jo korrekte në llogarinë 231 "Investime Kapitale të Trupëzuara" 11 projekte investimi me përshkrimin "Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve" dhe që përfaqësojnë 13,5% të këtij zëri.
- 9,713 milion lekë, si pasojë e regjistrimit të 546 kontrata, angazhime të cilat janë marrë pas datës 15 tetor, veprime këto në kundërshtim me nenin 51 "Menaxhimi i angazhimeve" të Ligjit nr. 9936, datë 2606.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- 7,044 milion lekë, konstatohet se, në zërin Investimeve Kapitale me Financim të Brendshëm të realizuara për vitin 2019 përfshihet edhe likuidimi i detyrimeve të prapambetura.
- 6,175 milion lekë, si pasojë e mbylljes pa realizim 129 projekte investimi, të cilat përfaqësojnë 8% të Investimeve Kapitale të Realizuara duke reflektuar në këtë mënyrë një planifikim të dobët të investimeve publike.
- 3,843 milion lekë, konstatohet se, shumë projekte investimi me financim të brendshëm, me Aktin Normativ nr. 11, datë 24/12/2019, kanë pësuar një ndryshim të madh në vlerë krahasuar me vlerën e miratuar të tyre sipas Ligjit të buxhetit të vitit 2019.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, në vlerën 7,454,116 mijë lekë, si pasojë e pasaktësive në raportimin e stokut të detyrimeve të prapambetura dhe që shumë nga masat dhe përmirësimet e akteve ligjore dhe nënligjore të hartuara me qëllim parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura, për raportimin në kohë të shpenzimeve, dhe marrjen e angazhimeve

financiare pa fonde buxhetore kanë rezultuar joefikase dhe të pazbatuara. Kështu, njësitë shpenzuese vijojnë të mos marrin miratimin e thesarit përpara fillimit të procedurave të prokurimit, duke ndërmarrë angazhime pa kaluar në të gjitha hallkat e miratimit dhe para se fondet të bëhen të vlefshme në SIFQ konstatuar në 42 raste.

Banka e Shqipërisë, në vlerën 108,874 mijë lekë, si pasojë e përfshirjes së detyrimit për pagesën e TVSH në përlllogaritjen e buxhetit dhe fondit limit të konstatuar në procedurën e prokurimit "Tender i kufizuar Ndërkombëtar" .

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në vlerën 10,499 mijë lekë, si pasojë e zhvillimit të procedurës së prokurimit mbi nevojat e planifikuara dhe pa fonde buxhetore, mungon planifikimi në Programin Buxhetor Afatmesëm edhe në Ligj Buxheti.

Agjencia e Blerjeve të Përqendruara (ABP), në vlerën 210,052 mijë lekë, si pasojë e skualifikimit të operatorëve që kanë pasur ofertat ekonomike në vlerë më të ulët se vlera e ofertave të operatorëve të shpallur fitues. Skualifikimi i këtyre operatorëve është bërë për mos përmbushjen e disa kriterëve të veçanta të cilat mund të konsideroheshin si devijime të vogla sepse nuk janë thelbësorë dhe nuk ndikonin në realizimin me sukses të kontratave të mallrave dhe shërbimeve. Ky problem ka ndodhur për shkak të mungesës së një pakete për të unifikuar kriteret e veçanta të kualifikimit për çdo grup mallrash dhe shërbimesh (p.sh, për tonerët, shërbimi i kateringut,etj).

Ministria e Kulturës, në vlerën 45,700 mijë lekë, për shkak se nuk është arritur konkurrenca minimale. Planifikimi i fondeve vetëm për realizimin e projekteve dhe jo për implementimin e tyre, e vendos MK-në përballë riskut potencial të keqmenaxhimit të fondeve buxhetore. Vlera e financuar vetëm për hartimin e projekteve për restaurimin, rikonstruksionin dhe rehabilitimin e hapësirave të Muzeut Historik Kombëtar dhe Muzeu Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria Kombëtare e Arteve).

Instituti i Monumenteve të Kulturës, në vlerën 1,394 mijë lekë, si pasojë e trajtimit në mënyrë jo të barabartë operatorët ekonomik. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për "*Restaurim Kisha "Shën Mërisë" Peshkëpi e Sipërme, Gjirokastër" 2018*, konstatohet se nga sistemi i vlerësimit të pikëve nga KVO, janë trajtuar në mënyrë të pabarabartë operatorët ekonomik.

Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, në vlerën 480 mijë lekë, si pasojë përdorimit të fondeve publike pa eficiencë, ekonomikitet dhe efektivitet. Sipas specifikimeve teknike të përcaktuara, qëllimi i punës është se operatori fitues duhet të eliminojë të gjitha defektet e shfaqura gjatë punës së ashensorëve dhe riparimin e tyre si dhe shërbimin e detyruar mujor dhe periodik.

Bashkia Ura Vajguore, në vlerën 343,492 mijë lekë, nga të cilat:

- Vlera 342,867 mijë lekë, si pasojë e mos zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore të ligjit të prokurimit publik në 43 procedura prokurimi, ku operatorët ekonomik të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DST të miratuara nga Autoriteti Kontraktor (AK). Kualifikimi i operatorëve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, por edhe risk real për shpenzimet

e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës

- Vlera 625 mijë lekë, rezulton neglizhencë nga Autoriteti Kontraktor në verifikimin e gjendjes dhe marrjen e masave të nevojshme për dokumentimin, mbrojtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve, me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e tyre nga dëmtimi dhe keqpërdorimi, në kontratën me objekt *"Rikualifikimi urban dhe krijimi i ambienteve të Rekreacionit në fshatin Donofrose"*.

Bashkia Finiq, në vlerën 138,142 mijë, si pasojë e mos zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore të ligjit të prokurimit publik në 14 procedura prokurimi, ku operatorët ekonomik të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DST të miratuara nga Autoriteti Kontraktor (AK). Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë, procedurat duheshin anuluar për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet (3E).

Bashkia Malësi e Madhe, në vlerën 118,639 mijë lekë, si pasojë e mos zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore të ligjit të prokurimit publik në 4 procedura prokurimi, ku operatorët ekonomik të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DST të miratuara nga Autoriteti Kontraktor (AK). Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë, procedurat duhej anuluar për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve publike.

Prefekti i Qarkut Tiranë, në vlerën 14,399 mijë lekë, nga të cilat:

- Vlera 12,208 mijë lekë, si pasojë e mos anulimit të procedurës për arsye se asnjë nga operatorët ekonomik pjesëmarrës nuk plotëson kriteret e vendosura në DST edhe pse janë evidentuar mangësi të konsideruara devijime të vogla në kriteret e kërkesave kualifikuese;
- Vlera 2,191 mijë lekë, si pasojë e marrjes në dorëzim të mjetit (dy mjete) e pa kërkuar, ndërkohë që AK ka bërë kërkesë për të prokuruar vetëm për 1 (një) automjet, megjithatë automjetet e kontraktuar janë marr në dorëzim nga komisioni, pa evidentuara në procesverbal në se, janë plotësuar kriteret e specifikimeve teknike që i përkasin kualifikimit me ato të vendosura në DST.

Bashkia Divjakë, në vlerën 2,123 mijë lekë, si pasojë e diferencave me ofertën e OE (operatorëve ekonomik) të shpallur fitues me ofertën e OE të skualifikuar. Veprimet dhe mosveprimet nuk përputhen me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi mbi prokurimet publike dhe kanë shkaktuar përdorim jo efektiv të fondeve në procedura prokurimi.

Bashkia Skrapar, në vlerën 1,248 mijë lekë, si pasojë e veprimeve e mos veprimeve të komisionit të vlerësimit të ofertave, Titullarit të Autoritetit Kontraktor dhe komisionit të marrjes në dorëzim të mallit, AK Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, ka blerë një mjet i cili nuk ka qenë objekt i procedurës së prokurimit (tenderit të zhvilluar) në datën 04.05.2017 me objekt "Blerje kamioni për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike.

Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, Bashkia Tiranë, në vlerën 187,755 mijë lekë, konsiderohet shpenzim i fondeve publike pa ekonomicitet, efience dhe efektivitet në 11 procedura prokurimi kanë rezultuar me shkelje. Në 3 procedura kriteret e vendosura në DST, të hartuara nga Njësia e Prokurimit dhe të miratuara nga titullari i Autoritetit Kontraktor nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës (zërat e preventivave), veprime të cilat direkt ose indirekt eliminojnë mos pjesëmarrjen e Operatorëve Ekonomik (OE) në garë ose janë kriteret për skualifikim të OE pjesëmarrës. Në 8 procedura OE/BOE janë shpallur fitues dhe pse kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DST.

Ujësullës Kanalizime Kavajë SHA, në vlerën 4,307 mijë lekë, konsiderohet shpenzim i fondeve publike pa ekonomicitet, efience dhe efektivitet. Në procedurat e prokurimit publik për vitin 2019, blerje me vlerë të vogël, u konstatua mungesa e plotësimit të kriterëve të veçanta të vendosura në DST nga Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël.

Rezidenca studentore nr.2 Tiranë SHA, në vlerën 914 mijë lekë, si pasojë e mos administrimit të fondeve publike dhe menaxhimit me ekonomicitet, efience dhe efektivitet të fondeve publike.

Projekti: Bulevardi verior dhe rehabilitimit i lumit të Tiranës, në vlerë 110,187 mijë lekë, si pasojë e realizimit të procesit të shpronësimit për interes publik, ndryshimet e projektit, përshtatjen me planin e zhvillimit. Gjithashtu njësia e zbatimit të projektit nuk ka kërkuar mbikëqyrësit të punimeve analizimin e saktë të kostove të punimeve të ndërtimit për punime të cilat nuk janë parashikuar në preventivin e tenderuar, si dhe nuk kanë referencë të drejtpërdrejtë në manualin e çmimeve të punimeve të ndërtimit.

Efekte financiare në fushën të tjera

Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, në vlerën 16,894,439 mijë lekë, nga të cilat:

- 16,799,439 mijë lekë, stoku i detyrimeve të prapambetura i raportuar në bazë të vetdeklarimeve të njësive buxhetore. Konstatohen diferenca në raportimet e pagesave për detyrimet e prapambetura krahasuar kundrejt pagesave të kryera faktikisht gjatë vitit 2019 për shpenzime për investime dhe shërbime.
- 95,000 mijë lekë, si pasojë e humbjeve financiare nga transaksioni SĚAP, konstatohen diferenca nga kurset e këmbimit të ofruara nga Banka e Shqipërisë për realizimin e kontratave SWAP në maturim në të gjitha rastet janë më të mëdha se kurset e këmbimit të ofruara në emetim;

Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, në vlerën 6,622,000 mijë lekë, si pasojë e detyrimeve të prapambetura: për institucionet qendrore në vlerën 2,910,000 mijë lekë, pasi ka institucione të cilat nuk kanë raportuar detyrimet e prapambetura ose kanë raportuar vlera jo të plota të detyrimeve të prapambetura. Gjithashtu për nivelin vendor stoku i detyrimeve të prapambetura ka konstatuar devijime në nivelin 3,712,000 mijë lekë.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë: "Mbi zbatimin e Buxhetit të vitit 2019", në vlerën 199,039 mijë lekë, si pasojë e përdorimit të fondit rezervë, në kundërshtim me ligjin organik të buxhetit, të ndryshuar dhe me udhëzimin standard të zbatimit të Buxhetit për vitin 2019.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në vlerën 11,251,390 mijë lekë, si pasojë e mos kryerjes së raportimeve me bazë tremujore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e prapambetura dhe të krijuara rishtazi sipas dokumentit standard "Shtojca 4", veprime në kundërshtim me Udhëzimin Plotësues Nr.1, datë 17.09.2019 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019", pika III, paragrafi 117. E vetmja evidencë për audituesin mbetet raportimi mbi gjendjen e stokut të rimbursimit nga DRTVSH në Drejtorinë e Analizës dhe Kontabiliteti në datën 31.12.2019.

Shërbimi Kombëtar i Punësimit, në vlerën 166,182 mijë lekë, si pasojë e mungesës së kontrollit të brendshëm dhe e monitorimit nga SHKP, mungesa e gjurmës së auditimit në mënyrë të vazhdueshme si dhe kreditimi i dyfishtë nëpërmjet faturave të blerjes së pa argumentuar, sjell një përdorim të fondeve pa ekonomikitet, efektivitet dhe eficiencë.

Bashkia Çerrik, në vlerën 10,599 mijë lekë, si pasojë e vlerësimit dhe shpalljes fitues në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim në DT, duke mos anuluar procedurën e prokurimit.


Rezidenca Studentore nr.2 Tiranë SHA, në vlerën 72,269 mijë lekë, ka ardhur si pasojë jo vetëm e mosplanifikimit të saktë të numrit të punonjësve por dhe mos sigurimit të plotësimit të kapaciteteve në dispozicion dhe mos marrjen e masave të duhura për përmirësimin e rezultatit financiar vjetor për të shpëtuar këtë shoqëri nga falimenti.

Projekti: Zhvillimi i Sektorit Privat në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në vlerën 295,130 mijë lekë, si pasojë e aplikimit nga Banka e Ndërmjetme komisione për kryerjen e shpenzimeve bankare, apo komisione për disbursimin e kredisë në përqindje të ndryshme të cilat variojnë nga 0.5% deri në 10% për 22 raste. Si rrjedhojë rezulton se shumatat janë përdorur pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet.

IV.AUDITIMET ME OPINION

Bazuar në planin vjetor, Kontrolli i Lartë i Shtetit, për vitin 2020, KLSH ka dhënë opinione për 45 misione auditimi, nga të cilat 5 janë opinione financiare, 28 opinione përputhshmërie dhe 12 janë opinione financiare dhe përputhshmërie.

Grafik nr. 14 Opinione e audituesit në %



Burimi KLSH

IV.1 DHËNIE OPINIONI PËR AUDITIMET FINANCIARE

Për periudhën Janar – Dhjetor të vitit 2020, KLSH ka kryer 5 auditime financiare nga të cilat 2 janë auditime ku janë dhënë opinione të kualifikuara në subjektet Bashkia Rrogzhinë dhe Bashkia Roskovec. Opinioni ka qenë i pakualifikuar në subjektin INSTAT dhe opinioni ka qenë i kundërt në Bashkinë Skrapar. Në Prokurorinë e Përgjithshme opinioni është dhënë i pakualifikuar me theksim çështje.

Tabela nr. 12 Opinioni për auditimet financiare

Nr.	SUBJEKTI	OPINIONI I AUDITUESIT				
		I Pakualifikuar ⁴		Opinion i kualifikuar ⁵		Opinion i kundërt
		Pa rezervë	Me rezervë	Pa rezervë	Me rezervë ⁶	
1	INSTAT	1				

⁴ Opinioni i pakualifikuar – Audituesi duhet të shpreh një opinion të pakualifikuar mbi rregullshmërinë e pasqyrave financiare kur ai/ajo konkludon se transaksionet financiare përputhen në të gjitha aspektet materiale me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

⁵ Opinioni i kualifikuar. Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: 1. kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose 2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.

⁶ Sipas Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, kapitulli IV, pika 4.2, "Opinion i me rezerve" do të jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt për një ose më shumë çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave. Nëse efekti financiar i paqartësisë apo i mosmarrëveshjes është i përcaktuar si shumë nga audituesi, ndonëse nuk është gjithmonë e praktikuar ose e përshtatshme, atëherë kjo do të shërbente si ndihmë për përdoruesit e pasqyrave.

2	Prokuroria e Përgjithshme		1			
3	Bashkia Rrogozhinë				1	
4	Bashkia Skrapar					1
5	Bashkia Roskovec				1	

Burimi KLSH

IV.2 DHËNIE OPINIONI PËR AUDITIMET E PËRPUTHSHMËRISË⁷

Bazuar në planin vjetor të auditimeve, për periudhën Janar – Dhjetor të vitit 2020, KLSH ka kryer 28 auditime përputhshmërie janë dhënë opinione për 25 auditime, nga të cilat 12 janë auditime ku janë dhënë opinione të kualifikuar në subjektet: Instituti i Monumenteve të Kulturës, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, Drejtoria e Shërbimit Kombëtar i Punësimit, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, DVASHK Mirëditë, DVASHK Përmet, DVASHK Mallakastër, Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Publik, Banka e Shqipërisë, në projektet "Zhvillimi i Sektorit Privat" dhe "Bulevardi Verior dhe Rehabilitimi i lumit të Tiranës".

Në subjektet si Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik dhe DVASHK Sarandë, Enti Rregullator i Ujit opinioni ka qenë i pakualifikuar.

Në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë: Drejtorinë e Përgjithshme e Thesarit, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë: "Mbi zbatimin e Buxhetit të vitit 2019", Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë: Drejtoria e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, Rezidencën Studentore nr.2 Tiranë SHA, Porti Detar Vlorë SHA, Ujësjetës Kanalizime Kavajë SHA, DRM dhe DRISHMPUT Vlorë dhe Lezhë grupi i auditimit ka arritur në konkluzionin e një Opinioni të Kundërt.

Tabela nr. 13 Opinioni për auditimet e përputhshmërisë

Nr.	SUBJEKTI	OPINIONI I AUDITUESIT					
		I Pakualifikuar		Opinion i kualifikuar		Opinion i kundërt	Komente
		Pa rezervë	Me rezervë	Pa rezervë	Me rezervë		
1	Drejtorja e Shërbimit të Trupit Diplomatik	1					
2	Instituti i Monumenteve të Kulturës				1		

⁷ Opinioni i pakualifikuar – Audituesi duhet të shpreh një opinion të pakualifikuar mbi rregullshmërinë e pasqyrave financiare kur ai/ajo konkludon se transaksionet financiare përputhen në të gjitha aspektet materiale me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Opinioni i kualifikuar – Objektivi i audituesit është të shpreh opinion të modifikuar në rastet kur:

a) Audituesi konkludon që llogaritë përmbajnë gabime materiale ose transaksionet nuk përputhen në të gjitha aspektet materiale me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi ose:

Kur audituesi e ka të pamundur të sigurojë evidenca të mjaftueshme dhe të nevojshme të auditimit, në mënyrë që të konkludojë se llogaritë nuk përmbajnë gabime materiale me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Nr.	SUBJEKTI	OPINIONI I AUDITUESIT					
		I Pakualifikuar		Opinion i kualifikuar		Opinion i kundërt	Komente
		Pa rezervë	Me rezervë	Pa rezervë	Me rezervë		
3	Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore			1			
4	Agjencia e Blerjeve të Përgendruara			1			
5	Drejtorja e Shërbimit Kombëtar i Punësimit			1			
6	Enti Rregullator i Ujit	1					
7	Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës			1			
8	Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Drejtorinë e Përgjithshme e Thesarit					1	
9	Ministria e Financave dhe Ekonomisë – Drejtorja e Përgjithshme e Buxhetit					1	
10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë: "Mbi zbatimin e Buxhetit të vitit 2019"					1	
11	Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Drejtorja e Përgjithshme e Borxhit Publik			1			
12	Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve					1	
13	Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Drejtorja e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik					1	
14	Banka e Shqipërisë			1			
15	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore						Pa opinion
16	ZVRPP Mirditë			1			
17	ZVRPP Përmet			1			
18	DVASHK Sarandë		1				
19	ZVRPP Mallakastër				1		
20	Ish-Drejtorja Rajonale e Mjedisit dhe Ish-DRISHMPUT Vlorë (aktualisht Drejtorja Rajonale e Mjedisit Fier)					1	
21	Drejtorinë Rajonale të Mjedisit Lezhë dhe Inspektoratin					1	

Nr.	SUBJEKTI	OPINIONI I AUDITUESIT					
		I Pakualifikuar		Opinion i kualifikuar		Opinion i kundërt	Komente
		Pa rezervë	Me rezervë	Pa rezervë	Me rezervë		
	Shtetërore të Mjedisit, Pyjeve, Ujrave dhe Turizmit Lezhë						
22	Rezidenca Studentore nr. 2 Tiranë SHA					1	
23	Porti Detar Vlorë SHA					1	
24	Ujësjellës Kanalizime Kavajë SHA					1	
25	Porti Detar Shëngjin SHA						Pa opinion
26	Projekti: Zhvillimi i Sektorit Privat			1			
27	Projekti: Ndërtimi i Bulevardit verior dhe rehabilitim i lumit të Tiranës			1			
28	Projekti: Lumi i Vlorës Loti I						Pa opinion

Burimi KLSH

IV.3 DHËNIE OPINIONI MBI PASQYRAT FINANCIARE DHE OPINION MBI PËRPUTHSHMËRINË

KLSH, për periudhën Janar – Dhjetor të vitit 2020, ka kryer 16 auditime rregullshme, për të cilat janë dhënë opinione mbi pasqyrat financiare dhe opinione mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së subjekteve të audituara për 12 auditime mix.

Tabela nr. 14 Opinioni mbi pasqyrat financiare dhe opinion mbi përputhshmërinë

Nr	SUBJEKTI	OPINION MBI PASOYRAT FINANCIARE				OPINION MBI PËRPUTHSHMËRINË			
		I Pakualifikuar		Opinion i kualifikuar	Opinion i kundërt	I Pakualifikuar		Opinion i kualifikuar	Opinion i kundërt
		Pa rezervë	Me rezervë			Pa rezervë	Me rezervë		
1	Ministria e Kulturës	1				1			
2	Aparati i Kryeministrit		1			1			
3	Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër	1							1
4	Prefekti i Qarkut Tiranë		1					1	
5	Bashkia Finiq				1				1
6	Bashkia Divjakë			1				1	
7	Bashkia Cërrik		1					1	
8	Bashkia Maliq		1					1	
9	Këshilli i Qarkut Gjirokastrë		1				1		

Nr	SUBJEKTI	OPINION MBI PASQYRAT FINANCIARE				OPINION MBI PËRPUTHSHMËRINË			
		I Pakualifikuar		Opinion i kualifikuar	Opinion i kundërt	I Pakualifikuar		Opinion i kualifikuar	Opinion i kundërt
		Pa rezervë	Me rezervë			Pa rezervë	Me rezervë		
10	Bashkia Malësi e Madhe	1				1			
11	Bashkia Ura Vajgurore			1			1		
12	Agjencia e Parqeve dhe e Rekreacionit			1				1	

Burimi KLSH

V. Auditimet e Performancës

Auditimi i performancës është shndërruar në një nga shtyllat e zhvillimit dhe modernizimit të KLSH-së. Gjatë viti 2020, KLSH ka iniciuar 16 auditime dhe ka evaduar 8 auditime performance nga Departamenti i Auditimit të Performancës dhe 1 auditim nga Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit. Fushat ku janë përqendruar këto auditime kanë vijuar të jenë:

- Reformat qeveritare;
- Projektet dhe shërbimet social-kulturore;
- Projektet dhe shërbimet social-ekonomike;
- Projektet mjedisore dhe energjetike;
- Projektet infrastrukturore;

Për secilin prej 9 auditimeve të performancës të zhvilluara nga Departamentet e Auditimit të Performancës dhe Buxhetit të Shtetit në KLSH përgjatë vitit 2020, më poshtë jepet një përmbledhje e shkurtër me objektivat dhe fokusimet kryesore të këtyre auditimeve, shoqëruar me problematikën, gjetjet, konkluzionet si dhe rekomandimet që janë dhënë nga grupet e KLSH-së për përmirësimin e situatës.

Efektiviteti i procesit të deinstitutionalizimit dhe decentralizimit të shërbimeve shoqërore me fokus fëmijët jetim

Pyetja kryesore

A kanë rezultuar efektive masat e marra për realizimin e procesit të deinstitutionalizimit dhe decentralizimit të shërbimeve të kryesore përkujdesit shoqëror për fëmijët jetim në vendin tonë për periudhën 2016 - 2019?

Mesazhi i auditimit:

Masat e marra nga institucionet përgjegjëse për proceset e deinstitutionalizimit dhe decentralizimit të shërbimeve shoqërore për fëmijët jetim në vendin tonë, jo vetëm nuk ka qenë efektive, por edhe janë shoqëruar me propagandë fiktive për realizimin e tyre.

Indicet e para të ndërmarrjes së kësaj reforme vihen re që në vitin 2003, dhe ende pas 17 vitesh nuk ka rezultate. Vetëm në vitin 2020 është hartuar një Draft Plan për deinstitutionalizimin. Institucionet shtetërore duhet të marrin hapa serioze në drejtim të kryerjes së këtyre proceseve pasi, institucionalizimi, përveçse është një dhunim i të drejtave të fëmijëve të të gjitha kategorive, ka pasoja serioze psiko – sociale për zhvillimin e tyre.

Subjektet e audituara:

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Shërbimi Social Shtetëror.

Periodha e auditimit: 2016 – 2018.

Mbi Auditimin

Ky auditim synoi të analizojë efektivitetin e masave të marra për realizimin e procesit të deinstitutionalizimit dhe decentralizimit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për fëmijët jetim në vendin tonë për periudhën 2016– 2019. Objektivi i këtij auditimi ka qenë vlerësimi i efektivitetit të procesit të deinstitutionalizimit dhe decentralizimit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për fëmijët jetim në vendin tonë në drejtim të planifikimit të saktë të procesit të deinstitutionalizimit dhe decentralizimit të shërbimeve të përkujdesjes sociale për fëmijët jetim dhe atë të progresit të arritur në zbatimin të masave të marra për këto procese.

Lidhur me gjetjet kryesore të këtij auditimi subjekteve të audituar, ndër të tjera, u është rekomanduar marrja e masave të mëposhtme:

të ndërmerren masat e nevojshme me qëllim miratimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit 121/2016 për shërbimet shoqërore;

të ndërmerren të gjitha iniciativat e nevojshme për të rishikuar Ligjin nr. 8153, datë 31 tetor 1996, " Mbi statusin e jetimit", i ndryshuar, duke reflektuar në të ndryshimet përkatëse në terminologji dhe kritere të përfitimit të statusit, nisur nga fakti se termi "jetim" nuk përmendet në asnjë dokument ndërkombëtar dhe as në Kodin e Familjes;

të vlerësohet mundësia e rishikimit të VKM nr. 149, datë 13.03.2018 " Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje", sa i takon masës së financimit për familjet kujdestare në varësi të kostove të ndryshme të jetesës në qytete të ndryshme;

të merren të gjitha masat me nevojshme për rishikimin e VKM nr. 149, datë 13.03.2018 " Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje", sa i takon reflektimit të impaktit të inflacionit në masën e financimit për familjet kujdestare;

të merren masa për hartimin e programeve proaktive për rritjen e përgjegjshmërisë prindërore, parandalimin e ndarjes së familjes, mbështetjen e nevojshme financiare

të tyre për të garantuar mos braktisjen e fëmijës, si dhe promovimin e ri integritit të konceptit të familjes.

të merren masa për ofrimin e qendrave të këshillimit psikosocial që në materni tet për nënat që rrezikojnë të braktisin fëmijët.

Eficienca e energjisë

Pyetja kryesore | A ka qenë efektive veprimtaria e institucioneve përgjegjëse në fushën e EE për periudhën 2016-2019?

Mesazhi i auditimit:

Masat e marra nga MIE dhe AEE lidhur me eficiencën e energjisë në vendin tonë nuk kanë qenë efektive. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë duke mos miratuar një sërë aktesh nënligjore ka dështuar të plotësojë Ligjin nr. 124/2015 "Për Eficiencën e Energjisë" dhe Ligjin nr. 116/2016 "Për Performancën e Energjisë në Ndërtesa". Metodologjia Kombëtare e Llogaritjes nuk është miratuar me VKM. MIE nuk ka hartuar Strategjinë për Rinovimin e Ndërtesave Publike dhe Planin Kombëtar për rritjen e numrit të ndërtesave me performancë "afër zero energji" si pjesë e PKVEE 2017-2020.

AEE nuk ka monitoruar PKVEE 2017-2020 dhe Ministri i MIE nuk ka raportuar asnjëherë në Këshillin e Ministrave mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë. Si rezultat i mungesës së MKLL dhe audituesve energjetikë të certifikuar nga AEE, deri më sot nuk është kryer asnjë auditim energjetik.

Mosfunksionimi i Fondit të Eficiencës së Energjisë ka çënuar financimin e programit në fushën e eficiencës së energjisë, zhvillimin e projekteve pilot për të studiuar teknologji të reja, kërkimin dhe zhvillimin e aktiviteteve për rritjen e EE, ndërmarrjen e fushatave ndërgjegjësuese si dhe zhvillimin e mekanizmave financiarë dhe fiskalë për nxitjen e investimeve. Projektet e eficiencës së energjisë të audituara në këtë auditim nuk kanë arritur objektivat e tyre kryesore. Pavarësisht situatës aktuale, gjatë kohës që ky auditim ishte duke u kryer (janar-qershor 2020), AEE ka hartuar dhe dërguar për miratim në MIE një sërë aktesh nënligjore. Miratimi i këtyre akteve, së bashku me zbatimin e rekomandimeve të lëna në këtë auditim subjekteve të audituara, do të sillte përmirësim në zbatimin e masave të eficiencës së energjisë.

Subjektet e audituara:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Agjencia e Eficiencës së Energjisë.

Periudha e auditimit: 2016 – 2019.

Mbi Auditimin

Auditimi me temë "Eficienca e Energjisë" i shtrirë në periudhën 2016–2019 ka synuar të analizojë efektivitetin e institucioneve subjekt auditimi të cilat janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë nxitjen dhe përdorimin eficient të

energjisë. Ky auditim ka patur për qëllim të ofrojë një tablo të qartë mbi integritetin, besueshmërinë, transparencën dhe efektivitetin e projekteve të eficiencës së energjisë të mbështetura nga qeveria shqiptare për të parë nëse këto projekte kanë sjellë përfitimet e pritshme për përfituesit dhe përdoruesit finalë. Fokusi i auditimit krahas shqyrtimit në tërësi të zbatimit të politikave qeveritare lidhur me eficiencën e energjisë ka qenë veçanërisht në sektorin e ndërtesave duke qenë se mundësitë për kursimin e energjisë në ndërtesa janë tepër të larta dhe ndikimi në shëndetin e popullatës lidhet ngushtë me marrjen e masave të përmirësimit të performancës së energjisë në ndërtesa. Performanca e energjisë në ndërtesa është një proces i tërë që kalon dhe përfshin hallka të ndryshme që duhet të jenë funksionale duke filluar me:

Metodologjinë Kombëtare të Llogaritjes;

Ndërtesat me performancë "afër zero energji";

"Certifikatën për performancën e energjisë" së ndërtesave;

Audituesit energjetikë për certifikimin e performancës së energjisë;

Shërbimet energjetike, etj.

Të gjitha elementët e mësipërm së bashku me promovimin, ndërgjegjësimin dhe edukimin e përdoruesve fundorë të energjisë nga ana e institucioneve përgjegjëse si dhe përfitimet e pritshme të projekteve në eficiencën e energjisë kanë kompletuar fokusimin tonë në këtë auditim.

Si rezultat i mungesës së MKLL dhe audituesve energjetikë të çertifikuar nga AEE, deri më sot nuk është kryer asnjë auditim energjetik. Mosfunksionimi i Fondit të Eficiencës së Energjisë ka cenuar financimin e programit në fushën e eficiencës së energjisë, zhvillimin e projekteve pilot për të studiuar teknologji të reja, kërkimin dhe zhvillimin e aktiviteteve për rritjen e EE, ndërmarrjen e fushatave ndërgjegjëse, zhvillimin e mekanizmave financiar dhe fiskal për nxitjen e investimeve. Projektet e audituara në këtë auditim nuk kanë arritur objektivat e tyre kryesore. Pavarësisht situatës aktuale, AEE gjatë gjashtë muorit të parë të 2020 ka hartuar dhe dërguar për miratim në MIE një sërë aktesh nënligjore. Miratimi i këtyre akteve, së bashku me zbatimin e rekomandimeve të lëna në këtë auditim subjekteve të audituara, do të sillte përmirësim në zbatimin e masave të eficiencës së energjisë.

Mungesa e realizimit të auditimeve energjetike (për periudhën 2016-2019) në përputhje me Ligjin nr. 124/2015 "Për Eficiencën e Energjisë" i ndryshuar, ka ardhur si rezultat i mungesës së Metodologjisë Kombëtare të Llogaritjes për performancën energjetike të ndërtesave si dhe mungesës së audituesve energjetike të certifikuar. "Metodologjia Kombëtare e Llogaritjes" (MKLL) së performancës së energjisë së ndërtesave nuk është e miratuar me VKM. Konceptet bazë të të dhënave nga MKLL ndihmojnë në ndërtimin dhe funksionimin e programit kompjuterik në lëshimin e certifikatës së performancës së energjisë. Mungesa e MKLL si dhe një programi kompjuterik të miratuar sjell dështimin e procesit të auditimit energjetik.

Edhe pse MIE ka mundësuar realizimin e disa projekteve dhe investimeve në rikonstruksionin/rinovimin e disa ndërtesave publike gjatë periudhës 2016-2019, ajo nuk

ka të dhëna mbi sipërfaqen totale të ndërtesave publike të rinovuara. Duke qenë se MIE nuk ka të përcaktuar në kriteret e veta përzgjedhëse një maksimum të periudhës së vetëshlyerjes për aprovimin e investimeve në eficiencën e energjisë, kjo ka cenuar në përzgjedhjen e projekteve kosto-efektive.

AEE është institucioni përgjegjës për të monitoruar dhe raportuar në MIE mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit të Eficiencës së Energjisë. Që nga momenti i themelimit të AEE-së e deri në 2019, ajo asnjëherë nuk ka monitoruar dhe raportuar në MIE mbi zbatimin e masave dhe objektivave të vendosura në PKVEE 2017-2020. Formatimi mbi mënyrën e raportimit të AEE-së në MIE nuk është miratuar me Urdhër të veçantë nga Ministri i MIE dhe kjo është një nga shkaqet kryesore të mosraportimit.

Ndotja e menjëhershme e Jonit dhe Adriatikut

Pyetja kryesore | A është menaxhimi i ndërhyrjes në rast ndotje të menjëhershme të detit Jon e Adriatik garant për ruajtjen e tij?

Mesazhi i auditimit:

“Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile të krijojë një qasje të re ligjore të bashkëpunimit me institucionet qendrore, pushtetin vendor, specialistë të fushës, institucionet ligjvënëse e grupet e interesit, në rritjen dhe forcimin e rrolit të saj koordinues, bashkërendues, drejtues, teknik, mbikëqyrës dhe kontrollues për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në të gjithë vendin

Subjektet e audituara:

- Ministria e Mbrojtjes;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Periudha e auditimit: 2017 – 2019.

Mbi Auditimin

Auditimi i performancës me temë “Ndotja e menjëhershme e Jonit dhe Adriatikut” u iniciua nga Zyra Shtetërore e Auditimit të Kroacisë si bashkëpunim rajonal me zyrat supreme të auditimit të Slovenisë, Italisë, Malit të Zi, Bosnje-Hercegovinës dhe Shqipërisë i cili filloi nëpërmjet një takimi të parë mbajtur në Kroaci e do të pasohet edhe me takime të tjera, të cilat nuk u finalizuan plotësisht për shkak të pandemisë globale COVID-19. Megjithatë, u ra dakord që secila nga zyrat të paraqesë auditimin e saj të pavarur nga ku do të realizohet një material përmbledhës me të gjitha problematikat sipas SAI-ve pjesëmarrëse. Edhe pse në këto vende, nuk kanë ndodhur ngjarje të përmasave të tilla që të klasifikohen si emergjenca mjedisore, rritja e aktivitetit tregtar, zhvillimi i vendeve tona që lagen nga këto dete dhe faktorët mjedisorë që gjithnjë e më tepër po impaktojnë negativisht klimën globale e atë rajonale, mund të shpien në katastrofa mjedisore, përmasat e të cilave mund të shumëfishohen, për specifikën që ka karakteri i mbyllur i detit Adriatik. Gjithashtu trajtimi i kësaj teme auditimi nga të gjitha

SAI-et rajonale, nën optikën e auditimit të performancës është i rëndësishëm, veçanërisht pasi mbrojtja e ujërave detare nga ndotjet është me ndikim të madh në mjedis, florën e faunën detare, në zhvillimin e turizmit, në të ardhurat e ekonomisë në tërësi si dhe me ndikim në shëndetin e popullsisë. Nëpërmjet këtij auditimi në këtë fushë është synuar në garantimin dhe ekzistencën e një reagimi të menjëhershëm, uniform dhe efektiv në nivel kombëtar ndaj incidenteve që mund të ndodhin në det, të cilat shkaktojnë ose mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit detar nga nafta ose substanca të tjera të dëmshme dhe të rrezikshme, të cilat e tejkalojnë kapacitetin e reagimit individual të anijeve, porteve, terminaleve të naftës, kantierëve detare, platformave detare, dhe të autoriteteve lokale ose rajonale. Objektivi i këtij auditimi ka qenë asistenca ndaj agjencive të ndryshme kombëtare, rajonale dhe lokale që të reagojnë ndaj incidenteve që shkaktojnë ose rrezikojnë të shkaktojnë ndotje të detit dhe të bregdetit shqiptar, duke analizuar problematikën aktuale e instrumentet që institucionet shtetërore kanë në dispozicion për ta përmirësuar atë.

Nga ky auditim rezultoi se nuk është hartuar strategjia për mbrojtjen civile si dokumenti bazë që përcakton politikat dhe objektivat, për të zvogëluar risqet e fatkeqësive, për të parandaluar, përgatitur, përballuar fatkeqësitë dhe për t'u rimëkëmbur nëpërmjet një sistemi të integruar dhe efikas me qëllim garantimin e mbrojtjes së jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore e të mjedisit, nëpërmjet forcimit të sistemit të mbrojtjes civile.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) nuk ka plane për rishikimin, përditësimin dhe përmirësimin e Planit Kombëtar për Përballimin e Emergjencave Civile, megjithëse në aktet nënligjore të ligjit nr. 45 "Për mbrojtjen civile" është parashikuar miratimi i Planit Kombëtar për Emergjencat Civile, çka nënkupton një përditësim të planit ekzistues, por në përputhje me vizionin dhe kërkesat e ligjit të ri. AKMC nuk ka të dhëna për hartimin, përpunimin dhe zbatimin e kurikulave të trajnimit në fushën e emergjencave dhe mbrojtjes civile.

Rekomandimi kryesor në këtë auditim theksoi rëndësinë e krijimit të një qasjeje të re ligjore të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile lidhur me bashkëpunimin me institucionet qendrore, pushtetin vendor, specialistë të fushës, institucionet ligjvënëse e grupet e interesit, në rritjen dhe forcimin e rrolit të saj koordinues, bashkërendues, drejtues, teknik, mbikëqyrës dhe kontrollues për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në të gjithë vendin.

Efektivi teti i politikave në lëvizjet migratore

Pyetja kryesore | "A është efektive qeverisja e migracionit nga MB dhe MFE për periudhën 01.01.2015 – 31.12.2019?"

Mesazhi i auditimit:

Emigrimi i shtetasve shqiptarë për motive punësimi sot rregullohet nga një ligj i papërditësuar, i cili sot zbatohet kryesisht në funksion të qëllimit dhe parimeve të përgjithshme, por jo për sa i përket veprimeve procedurale. Ndryshimet e shumta në

strukturat përkatëse dhe mangësitë në identifikimin e autoriteteve përgjegjëse kanë bërë që një pjesë e madhe e dispozitave të tij të jenë të pazbatueshme.

Për më tepër, angazhimi i dokumenteve strategjike dhe institucioneve përgjegjëse të fushës është drejtuar kryesisht drejt riintegritit dhe rikthimit të personave të larguar, duke neglizhuar shtetasit e kualifikuar që përbëjnë potencial për të emigruar.

Megjithatë dëshira e shqiptarëve për t'u larguar nuk diktohet drejtpërdrejt nga mangësitë e kuadrit ligjor e rregullator. Arsyet që i shtyjnë ata për të emigruar janë kryesisht ato ekonomike, standardet e jetesës, papunësia, rrogat e ulëta, por edhe mundësia për një arsim më të mirë apo mungesa e shpresës se gjerat në vend do të përmirësohen. Mungesa e të dhënave statistikore të sakta dhe bashkëpunimi i ulët ndërinstitucional për të siguruar informacion cilësor mbi migracionin, rrezikojnë zbatimin me efektivitet të politikave migratore.

Subjektet e audituara:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Ministria e Brendshme;
- Instituti i Statistikave.

Periudha e auditimit: 2015 – 2019.

Mbi auditimin

Auditimi i performancës me temë “Efektiviteti i politikave në lëvizjet migratore” u fokusua në analizimin e shkallës së zbatimit të politikave shtetërore për mirëqeverisjen e emigracionit dhe zbutjen e faktorëve që shtyjnë individët për t'u larguar nga vendi si dhe në vlerësimin e veprimtarisë së institucioneve përgjegjëse për të siguruar mekanizmat e menaxhimit, administrimit dhe monitorimit të tij. Gjithashtu, u vlerësua kuadri rregullator në fuqi për menaxhimin e migracionit, eficientia e strukturave përgjegjëse për migracionin në institucionet e audituara, grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave mbi migracionin si dhe raportimi i tyre. Emigrimi i shtetasve shqiptare për motive punësimi sot rregullohet nga një ligj i pa përditësuar, i cili zbatohet kryesisht në funksion të qëllimit dhe parimeve të përgjithshme, por jo për sa i përket veprimeve procedurale. Ndryshimet e shumta në strukturat përkatëse dhe mangësitë në identifikimin e autoriteteve përgjegjëse kanë bërë që një pjesë e madhe e dispozitave të tij të jenë të pazbatueshme duke cenuar rregullimin ligjor të një kategorie të gjerë të migracionit, emigrimin për motive punësimi. Për më tepër, angazhimi i dokumenteve strategjike dhe institucioneve përgjegjëse të fushës është drejtuar kryesisht drejt riintegritit dhe rikthimit të personave të larguar, duke neglizhuar shtetasit e kualifikuar që përbëjnë potencial për të emigruar.

Mungesa e një Regjistri të plotë për emigrantët dhe të dhënave të sakta nga institucionet ,rrjedhimisht bën që këto të dhëna të kenë një marzh të caktuar gabimi. Diçka e tillë konstatohet edhe nëse shqyrtohen shifrat që nxjerr INSTAT dhe ato që dalin nga anketime të tjera për migracionin. Faktorët ekonomikë kanë qenë dhe janë dominues për sa i përket nxitësve të emigracionit në Shqipëri, megjithatë në një pjesë të konsiderueshme rastesh, shqiptarët preferojnë të emigrojnë edhe për arsye më pak të matshme, si p.sh. mungesa e shpresës për një të ardhme të përshtatshme.

Ministria e Brendshme nuk ka shfrytëzuar burimet e veta njerëzore dhe logjistike për të mbledhur dhe ruajtur të dhënat për emigracionin e shtetasve shqiptarë, si dhe nuk ka bërë raportime periodike në INSTAT. Departamenti i Kufirit dhe Migracionit në MB, nuk ka marrë masa për të mbledhur të dhëna manuale apo elektronike për emigrantët shtetas shqiptarë, për destinacionin ku largohen dhe llojin e statusit që kanë në vendin ku emigrojnë. Mungesa e rrjedhës së qartë të informacionit lidhur me migracionin nga institucionet përgjegjëse tek INSTAT, ka sjellë efektivitet të ulët në përmbajtjen e informacionit që agjencitë statistikore ofrojnë. Megjithatë dëshira e shqiptarëve për t'u larguar nuk diktohet drejtpërdrejt nga mangësitë e kuadrit ligjor e rregullator. Arsyet që i shtynjë ata për të emigruar janë kryesisht ato ekonomike, standardet e jetesës, papunësia, rrogat e ulëta, por edhe mundësia për një arsim më të mirë apo mungesa e shpresës se gjerat në vend do të përmirësohen. Mungesa e të dhënave statistikore të sakta dhe bashkëpunimi i ulët ndërinstitucional për të siguruar informacion cilësor mbi migracionin, rrezikojnë zbatimin me efektivitet të politikave migratore.

Për të përmirësuar situatën, KLSH ka lënë rekomandimet e duhura që shkojnë kryesisht për, vlerësimin e zbatimit të ligjit të emigrimit për motive punësimi dhe përditësimin e tij, hartimin e programeve që trajtojnë parandalimin e largimit të personave të kualifikuar drejt vendeve të tjera, grumbullimin dhe publikimin e të dhënave më të detajuara në lidhje me faktorët që i shtynjë shqiptarët drejt emigracionit, hartimin e regjistrit të emigranteve me të dhëna të sakta rreth shtetasve shqiptarë që duan të emigrojnë për qëllime punësimi, forcimin e bashkëpunimit midis strukturave përgjegjëse me qëllim përdorimin efektiv të informacionit, etj.

Efektiviteti i koordinimit ndërinstitucional në kuadër të procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian për periudhën 2016 – 2019

Pyetja kryesore | A siguron MEPJ një rishikim vjetor efektiv të PKIE, me qëllim realizimin e objektivave të përcaktuara është i plotësuar kuadri ligjor mbi ndotjen akustike me akte nënligjore dhe a kanë qenë efektive ato?

Subjektet e audituara:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- Bashkia Shkodër;
- Bashkia Vlorë.

Periudha e auditimit: 2016 – 2019.

Mbi Auditimin

Ky auditim ka synuar të analizojë efektivitetin e koordinimit ndërinstitucional nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe njësitë e qeverisjes vendore për procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian për periudhën 2016 – 2019. Objektivat e këtij auditimit kanë për qëllim të sigurojnë një informacion të plotë, të drejtë dhe vlerësues mbi koordinimin ndërinstitucional, konkretisht: Organizimin e MEPJ dhe Bashkitë Shkodër dhe Vlorë; Zbatimin e afateve lidhur me informimin dhe komunikimin

ndërinstitucional; Koordinimin dhe hartimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE), me qëllim realizimin e objektivave të përcaktuara në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit dhe procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian; Koordinimin dhe bashkëveprimin ndërinstitucional si dhe raportimin në kuadër të negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Për sa më sipër disa nga gjetjet më kryesore të këtij auditimi janë si vijon:

MEPJ, e cila që pas tetorit 2017 ka për detyrë koordinimin e brendshëm dhe të jashtëm të procesit, ka një bilanc pune me deficite, qoftë në organizimin e brendshëm, duke tërhequr vëmendjen e Komisionit Evropian i cili ka kërkuar një angazhim të shtuar për forcimin e kapaciteteve administrative, qoftë në funksionimin e jashtëm, nëpërmjet përfaqësive tona diplomatike të akredituara në vendet e BE-së.

Me gjithë përpjekjet që kjo ministri ka bërë gjatë periudhës 2016 - 2019, për realizimin e objektivave të hartimit, koordinimit, zbatimit dhe monitorit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, ajo ka rezultuar në mangësi të dukshme në miratimin e një metodologjie për hartimin e një Plani Kombëtar për Integrimin Evropian.

Qeveria shqiptare ka hartuar aktet ligjore dhe nënligjore që mundësojnë ngritjen e njësive të integritetit, që mbështesin proceset integruese pranë NJQV-ve jashtë afateve ligjore.

Njësitë e integritetit evropian të pretenduara si të ngritura nga NJQV-të, janë në fakt koordinatore lokale për zbatimin e projektit "Bashkitë për në Evropë" dhe jo Njësi të Integritetit në përputhje me kërkesat ligjore.

Monitorimi i kryer nga MEPJ (dhe ish-MIE), për ngritjen dhe funksionimin e strukturave të NJIE-ve, është thujse inekzistent.

NJQV-të nuk kanë publikuar në faqet e tyre zyrtare, informacion rreth Bashkimit Evropian, procesit të integritetit evropian, të drejtat dhe detyrimet që vijnë si pjesë e procesit të anëtarësimit, si dhe programeve të ndryshme të financimit të BE-së.

Për përmirësimin e situatës janë dhënë një sërë rekomandimesh, ku ato më kryesoret kanë të bëjnë me:

ngritjen e një grupi pune që të hartojë dhe më pas të miratohet metodologjia dhe/ose udhëzimi për hartimin dhe rishikimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian;

bashkëpunimin dhe bashkërendimin e MEPJ me strukturat e tjera të integritetit dhe me Grupet Ndërinstitucionale të Punës për rishikimin sa më efektiv të PKIE-së, në mënyrë që takimet dhe mbledhjet mos të jenë vetëm ato që janë programuar paraprakisht, por sa herë të jetë e nevojshme, duke përfshirë në mënyrë sa më të saktë rekomandimet e KE;

MEPJ në fund të çdo viti të kryejë publikimin e listës së aktiviteteve trajnuese që parashikon të kryejë gjatë vitit, si dhe të marrë masa për vënien në dijeni të NJQV për këto trajnime;

Ecuria e borxhit tatimor

Pyetja kryesore | A ka qenë efektive mbledhja e borxhit tatimor për periudhën 2017-2019?

Mesazhi i auditimit:

Menaxhimi i borxhit tatimor në nivel strategjik është mbështetur në një planifikim të dobët si rezultat i mungesës së një angazhimi të kujdesshëm dhe të efektshëm në ndarjen e strukturave përgjegjëse për kryerjen e aktiviteteve strategjike, si dhe mungesës së treguesve të matshëm për të vlerësuar realizimin e këtyre aktiviteteve vit pas viti, duke shkaktuar kështu pamundësinë për të monitoruar dhe vlerësuar realizimin e nën objektivit strategjik "Mbledhja efikase dhe efektive e borxhit", nëpërmjet treguesve të përcaktuar në strategji. Mungesa e stafit të nevojshëm në Drejtoritë/Sektorët e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në drejtoritë rajonale, gjatë periudhës nën auditim 2017-2019, ka ndikuar negativisht në zbatimin e masave shtrënguese për mbledhjen e borxhit tatimor, si dhe në monitorimin e procesit. Për 20 tatimpaguesit me vlerë më të lartë borxhi të secilës prej 13 DRT-ve të marrë në shqyrtim nga grupi i auditimit, të cilët gjatë vitit 2019 kanë shtuar borxhin tatimor me 8,825,112 mijë, niveli i arketimeve nga zbatimi i masave shtrënguese ka qenë i ulët. Mos identifikimi i të gjitha pasurive të luajtshme të tatimpaguesve debitorë, si dhe mos regjistrimi i barrëve siguroese në Regjistrin e Barrëve Siguroese ka ndikuar negativisht në mbledhjen dhe menaxhimin e borxhit tatimor. Në vitin 2019, për 30 tatimpagues me vlerë borxhi 13,411,106 mijë lekë, si rezultat i mungesës së bashkëpunimit midis institucioneve që regjistrojnë pasuri të luajtshme/të paluajtshme dhe Drejtorive/Sektorëve të Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, këto të fundit nuk kanë mundur të zbatojnë masat shtrënguese në mënyrë shteruese. Problematika janë evidentuar edhe në marrëveshjet me këste të lidhura, dhe rastet e tatimpaguesve debitorë për përcjellje tek DHT. Në vitin 2019, në DRT Dibër borxhi në vlerë 129,404 mijë lekë i 35% të tatimpaguesve debitorë të marrë në shqyrtim, nuk është ndjekur me masa shtrënguese në mënyrë shteruese.

Kjo situatë ka sjellë që niveli i borxhit tatimor në fund të vitit 2019 të ketë arritur në vlerën 116,994,227 mijë lekë, çka tregon se procesi i mbledhjes së borxhit tatimor nga strukturat e mbledhjes me forcë në Drejtoritë Rajonale Tatimore nuk ka qenë efektiv.

Subjektet e audituara: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Periudha e auditimit: 2017 – 2019

Mbi Auditimin

Për përmirësimin e situatës janë dhënë një sërë rekomandimesh, ku ato më kryesoret kanë të bëjnë me:

1. Komiteti i Reformave të përditësojnë Planin Strategjik 2017-2021, duke lidhur në mënyrë specifike dhe të qartë aktivitetet strategjike me strukturat përgjegjëse për zbatimin e tyre. Mbështetur në analiza, të përditësohet strategjia me indikatorë të matshëm, të arritshëm dhe relevant, si dhe të përcaktohen dhe miratohen targetat/rezultatet e pritshëm strategjik dhe operacional, me shifra dhe narrative, me qëllim që të forcohet më shumë funksioni i menaxhimit të detyrimeve tatimore

- të papaguara, rritja e efektivitetit të këtij procesi, përmirësimi i përmbushjes vullnetare të tatimpaguesve dhe roli i DPT-së në mbledhjen e borxhit.
2. Komitetet menaxheriale të punës në DPT të forcojnë rolin e tyre në drejtimin menaxherial nëpërmjet zhvillimi të takimeve në përputhje me Urdhrin nr.16, datë 02.03.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së dhe të monitorojnë zbatimin e Strategjisë së DPT-së në lidhje me menaxhimin e borxhit tatimor, me qëllim arritjen e objektivave dhe rritjen e performancës së institucionit.
 3. Titullari i institucionit në mbledhjet me Komitetet e punës në DPT të ndërmarrin masa për përditësimin e Manualit të Mbledhjes me Forcë, Udhëzuesit të përgjithshëm, si dhe dokumenteve të tjera të punës, për të siguruar identifikimin e të gjitha pasurive të luajtshme të tatimpaguesve debitorë mbi të cilat mund të vendoset barrë siguroese dhe vijimin me fazat e tjera të mbledhjes me forcë.
 4. Strukturat e mbledhjes me forcë në DRT, për të gjithë tatimpaguesit debitorë me mangësi në praktikën e ndjekur në lidhje me identifikimin e të gjithë pasurive të luajtshme dhe vendosjen e barrës siguroese për to, të plotësohen hapat e përcaktuara në pikën 91.2.5 të Nenit 91 të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 24, datë 02.09.2008, "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*", me përparësi tatimpaguesit me nivel më të lartë të borxhit deri tek ata me nivel më të ulët të borxhit.
 5. DMDTP në DPT, nëpërmjet vizitave të inspektimit në Drejtoritë Rajonale Tatimore, të analizojë në mënyrë të detajuar dosjet e tatimpaguesve debitorë lidhur me zbatimin e masave shtrënguese dhe ndërveprimin e Drejtorive/Sektorëve të Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara të DRT-ve me institucione të tjera, si dhe të kryejë intervista me stafin e Drejtorive/Sektorëve të mbledhjes me forcë. Problematikat e identifikuar të pasqyrohen në raportet e inspektimit, si dhe të ndërmerren masat e nevojshme për përmirësim e mbledhjes me forcë të borxhit tatimor.
 6. DHT në bashkëpunim me DMDTP në DPT të ndërmarrin masat e nevojshme për të qartësuar dhe siguruar zbatueshmërinë e Udhëzimit Nr. 41, datë 13.06.2017 "*Për bashkëpunim ndërmjet strukturave të administratës tatimor për trajtimin e rasteve që përmbajnë elementë të veprës penale në fushën e tatimeve*", pika 7, nga strukturat e mbledhjes me forcë.
 7. DHT në bashkëpunim me DMDTP dhe DBNJ në DPT të zhvillojnë trajnime për inspektorët e mbledhjes me forcë, mbi identifikimin e rasteve të tatimpaguesve të cilët përmbajnë elemente të veprës penale, dhe përcjelljen e tyre për ndjekje DHT-së për të siguruar zbatimin e Udhëzimit Nr. 41, datë 13.06.2017.
 8. DPT të ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar një monitorim sa me efikas të marrëveshjeve të lidhura për pagesë me këste me tatimpaguesin debitorë nga strukturat përgjegjëse në drejtoritë rajonale tatimore, duhet të kërkojë nga DRT-të (strukturat përkatëse) hartimin e raporteve periodike mbi ecurinë dhe problematikat e evidentuara gjatë zbatimit të akt-marrëveshjeve me qëllim evidentimin dhe zgjidhjen në kohë të tyre.
 9. Titullari i institucionit të ndërmarrë masa për kryerjen e analizave të veçanta për rastet e tatimpaguesve debitorë të cilat janë në proces apelimi duke analizuar në

- përfundim çdo përgjegjësi për vlerat të cilat sjellin risk të shtuar për institucionin.
10. Nga ana e strukturave të mbledhjes me forcë në DPT dhe në DRT të kryhen analiza periodike të thelluara mbi gjendjen e detyrimeve tatimore të papaguara në afat, shkaqet e rritjes së tyre dhe parashikimet për vjeljen e tyre në të ardhmen.
 11. DPT dhe DRT-të duhet të përdorin informacionet që mbajnë për tatimpaguesit, për të ndërtuar profile të riskut për secilin prej tyre me borxh, përcaktimin e përparësive dhe përshtatjen e veprimeve të grumbullimit të borxheve. Nga ana e DRT-ve të zbatohen dhe monitorohen të gjitha masat shtrënguese për subjektet që evidentohen me të ardhura nga veprimtari ekonomike me kasë fiskale të në zbatim të kërkesave të ligjit nr.9920, datë19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 88-101.
 12. DRT, të zbatojnë rregullisht metoda e vlerësimit të riskut nëpërmjet strukturave përkatëse të ngarkuara me mbledhjen me forcë, për të përcaktuar dhe zbatuar, në çdo rast, masën më të përshtatshme të mbledhjes me forcë, duke parandaluar krijimin e detyrimeve të papaguara me vlera të vogla, dhe ato të reja (brenda vitit të krijuara) me qëllim që të maksimalizohet mbledhja e detyrimeve tatimore të papaguara duke i kushtuar kujdes borxhit të ri të krijuar.

Sistemi i menaxhimit të shërbimit shëndetësor në institucionet e arsimit parashkollor

Pyetja kryesore | Si ka funksionuar sistemi i menaxhimit për ofrimin e shërbimit mjekësor në arsimin parashkollor për periudhën 2017-2019?

Mesazhi i auditimit:

"Sistemi i Menaxhimit të Shërbimit Shëndetësor në IAP nuk ekziston. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) nuk ka shfaqur iniciativa për të përditësuar dhe plotësuar me akte nënligjore të mjaftueshme të gjithë kuadrin ligjor në lidhje me Sistemin e Menaxhimit të Shërbimit Shëndetësor në IAP dhe nuk e ka përfshirë në dokumentet politike të saj. Aktualisht ky shërbim ofrohet i pjesshëm vetëm në Bashkinë Tiranë duke ju referuar kuadrin rregullator të pa përditësuar të vitit 1998. Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë dhe Autoriteti Shëndetësor Rajonal Tiranë (si struktura e mëparshme) kanë ofruar shërbimin pa patur në strukturë të specifikuar mjekët që do të ofrojnë shërbimin dhe pa një kuadër rregullator të mirë përcaktuar në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë.

OSHKSH me Drejtoritë Rajonale të OSHKSH-të si struktura të reja, të krijuara në vitin 2019, shfaqin problematika në menaxhimin e këtij sistemi duke shfaqur të paqarta rolet dhe përgjegjësit e tyre. Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Vlorë nuk e njeh si shërbim direkt të saj duke jua lenë si kompetencë Qendrave Shëndetësore.

Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, strukturë e mirë organizuar në ofrimin në tërësi të shërbimit për mirë rritjen e fëmijëve në çerdhe e kopshte shfaq mangësi në argumentimin e pozicionit të mjekut, pjesë e organikës së saj. Bashkia Vlorë për periudhën në auditim 2017 – 2019 nuk ka strukturën e përshtatshme për

menaxhimin e IAP, dhe nuk ka të parashikuar në objektivat e saj, ofrimin e shërbimit të mjekut në IAP".

Subjektet e audituara:

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (me drejtorit e varësisë)
- Drejtoria Qendrore e Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor;
- Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor, Tiranë;
- Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor, Vlorë;
- Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Tiranë;
- Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Vlorë;
- Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve
- Bashkia Vlorë

Periudha e auditimit: 2017 – 2019

Mbi Auditimin

Për përmirësimin e situatës janë dhënë një sërë rekomandimesh, ku ato më kryesoret kanë të bëjnë me:

- Drejtoria Qendrore e OSHKSH të ngrëjë një grup pune me specialistë/ekspertë të Drejtorisë së Harmonizimit të Kujdesit Shëndetësor në bashkëpunim me Drejtorinë e Racionalizimit të Kujdesit Shëndetësor dhe Drejtorinë e Ofrimit të Kujdesit Shëndetësor, për të kryer identifikimin e nevojave vlerësimin e shërbimit të mjekut në IAP, bazuar në të dhënat që do grumbullohen nga Drejtoritë Rajonale OSHKSH, studime dhe praktika të mira, me qëllim dizenjimin e një sistemi eficient të menaxhimit të shërbimit në gjithë territorin.
- MSHMS të marrë masa për përfshirjen e shërbimit të mjekut në IAP në dokumentet strategjike sipas vlerësimin të kryer nga Drejtoria Qendrore e OSHKSH.
- Në zbatim të Ligjit nr.10/107 datë 30.3.2009 "Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 40 pika 2, MSHMS të marrë masat në dizenjimin dhe rregullimin e akteve nënligjore dhe në përditësimin e dokumenteve rregullator ekzistues.
- Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në MSHMS të sigurojë burimet njerëzore për realizimin e detyrave në funksion të sistemit të menaxhimit të shërbimit shëndetësor në IAP, të përcaktuara në Urdhrin nr.178 datë 22.02.2018 "Për Miratimin e Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funkcionimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale". MSHMS të ngarkojë zyrtarin përgjegjës për mbikëqyrjen e Operatorit në realizimin e objektivave të miratuar politike dhe të menaxhimit të ligjshmërisë dhe përshtatshmërisë së veprimeve të tyre administrative në zbatim të Urdhrit nr.18, datë 17.01.2019 për "Miratimin e Rregullores së Brendshme për Mënyrën e Organizimit dhe Funkcionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor", neni 28.
- OSHKSH, të propozoj përditësimin e rregullores miratuar me Urdhrin nr.18 datë 17.01.2019 "Për Miratimin e Rregullores së Brendshme për Mënyrën e Organizimit dhe Funkcionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor" për të përcaktuar qartazi detyrat mbi të cilat drejtorit e varësisë, DR OSHKSH dhe NJVKSH duhet të ushtrojnë funksionet e tyre në ofrimin e shërbimit shëndetësor në IAP.

- Me qëllim përmirësimin e situatës, rekomandojmë që nga ana e Drejtorisë Qendrore të Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor pas vlerësimit të shërbimit të mjekut në IAP, të merren masa për unifikimin e rregulloreve të Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor duke patur parasysh specifikat e secilës strukturë.
- Drejtoria Qendrore e OSHKSH pas vlerësimit të shërbimit të mjekut në IAP, të ngrejë struktura të dedikuara për shërbimin në varësi të nevojave.
- Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në MSHMS të marrë masat në vendosjen e linjave të bashkëpunimit me strukturën e varësisë OSHKSH me qëllim mirë funksionimin e këtij sistemi.
- Pas vlerësimit të shërbimit të mjekut në IAP, Drejtoria Qendrore e OSHKSH të marrë masa për përditësimin e Rregullos Nr. 2370 datë 09.06.1998 për Shërbimin Shëndetësor në Çerdhe dhe Rregullos nr. 2560 datë 29.7.1998 për Shërbimit Shëndetësor në institucionet parashkollore dhe shkollore dhe të përcaktojë sistemin e raportimit.
- Pas vlerësimit të shërbimit të mjekut në IAP, Drejtoria Qendrore e OSHKSH të marrë masa për përfshirjen në sistemin e raportimit edhe Drejtorinë e Përgjithshme të Çerdheve dhe Kopshteve, si strukturë menaxhuese e IAP.

Menaxhimi i transportit hekurudhor në Shqipëri

Pyetja kryesore

A ka qenë efektiv menaxhimi i transportit hekurudhor në Shqipëri në periudhën 2016-2019?

Mesazhi i auditimit:

Masat e marra nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Hekurudha Shqiptare SH.A lidhur me menaxhimin e transportit hekurudhor në Shqipëri nuk kanë qenë efektive. Ligji nr. 142/2016, datë 22.12.2016 "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë" nuk është zbatuar plotësisht. Arsyeja kryesore e mos zbatimit të këtij ligji është mos krijimi i Autoritetit Rregullator Hekurudhor, Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore, Autoritetit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore dhe Autoritetit Licencues Hekurudhor. Për ngritjen e këtyre autoriteteve MIE nuk ka hartuar kuadrin ligjor të posaçëm në përputhje me Ligjin nr. 142/2016, datë 22.12.2016 "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë". Investimet në sektorin e transportit hekurudhor për periudhën 2016-2019 nuk kanë qenë të mjaftueshme duke mos realizuar disa prej objektivave kryesore të Strategjisë Sektoriale të Transportit 2016-2020. Treguesit kryesorë të performancës së sistemit hekurudhor janë në nivele shumë të ulta. Numri i pasagjerëve hekurudhorë për vitin 2019 ishte më i ulët i shënuar të paktën prej disa dekadash. Cilësia e shërbimit, siguria hekurudhore së bashku me infrastrukturën hekurudhore janë në gjendje të mjerueshme. Linjat hekurudhore sot janë tkurrur si kurrë më parë si rezultat i përkeqësimit dhe daljes jashtë funksionit të disa veprave kryesore të artit si ura e Ishmit, ura e Rrogozhinës etj.

Subjektet nën auditim:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;

Hekurudha Shqiptare SHA.

Mbi Auditimin

Për përmirësimin e situatës janë dhënë një sërë rekomandimesh, ku ato më kryesoret kanë të bëjnë me:

- Ministri i MIE të marrë masa për hartimin dhe miratimin e Rregullores së Brendshme të organizimit dhe funksionimit të saj.
- MIE të ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar funksionimin e plotë të Ligjit Nr. 142/2016, datë 22.12.2016, Kodit Hekurudhor të Republikës së Shqipërisë, duke mundësuar ngritjen e Autoritetit Rregullator Hekurudhor, Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore, Autoritetit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore dhe Autoritetit Licencues Hekurudhor.
- Certifikimi i spërmarësve hekurudhorë duhet të kryhet në përputhje me Ligjin Nr. 142/2016, datë 22.12.2016, Kodit Hekurudhor të Republikës së Shqipërisë.
- Hekurudha SHA si dhe Drejtuesi i Ekipit të Menaxhimit të Programit Buxhetor për transportin hekurudhor në MIE të ndërmarrin masat e nevojshme për të raportuar pranë MFE dhe Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MIE projektet e huaja të përfituara, të cilat kanë ndikim në buxhetin e shtetit, për të siguruar transparencë mbi financimet e huaja të kryera në programin Transporti Hekurudhor. Gjithashtu, brenda muajit shkurt të vitit pasardhës të përfundimit të vitit buxhetor, të paraqesin pranë Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MIE, raportin e monitorimit të zbatimit të buxheti me shifra dhe narrative, duke siguruar paraqitjen në to edhe të nivelit të realizimit të financimeve të huaja.
- MIE në bashkëpunim me Hekurudha SHA të analizojnë në mënyrë të kujdesshme totalin e fondeve të investuara dhe efektivitetin e tyre për sektorin e hekurudhës për periudhën 2016-2019, të identifikojë arsyet që kanë ndikuar në nivelet e ulëta të investimeve për këtë periudhë dhe të ndërmarrin masa për rritjen e tyre.
- MIE të analizojë në mënyrë të kujdesshme arrijten e veprimeve prioritare në sektorin e hekurudhës, të parashikuara në dokumentin strategjik të zhvillimit të transportit, të identifikojë për secilin prej tyre shkaqet e mos arrijtes së tyre dhe niveleve të ulët të financimeve, dhe të ndërmarrë masat e nevojshme për përmirësim.
- Në vijim të analizimit të shkaqeve të cilat kanë ndikuar në mosrealizimin e objektivave të parashikuar për transportin hekurudhor për periudhën 2016-2019 MIE të kenë ato në konsideratë, në përditësimin e Strategjisë Sektoriale të Transportit, me qëllim që të vendos objektiva të arritshëm dhe të mbështetur me fonde të cilat kanë siguri se do të përfitohen.
- Hekurudha Shqiptare SHA të marrë masa për eliminimin e të gjitha kalesave të paligjshme në brendësi të stacioneve hekurudhore.
- Hekurudha Shqiptare SHA të marrë masa për përmirësimin e kushteve të shërbimit dhe cilësisë së godinave të stacioneve hekurudhore.

- MIE në bashkëpunim me Hekurudhën Shqiptare SH. A dhe Drejtorinë e Inspektoratit Hekurudhor të ngrenë një grup pune me qëllim prishjen e të gjithë kalesave të paligjshme në rang vendi dhe të nxjerrin përgjegjësit që me veprime dhe mos veprimet e tyre kanë sjellë lejimin e këtyre kalesave të paligjshme. Gjithashtu, në punën për prishjen e kalesave të paligjshme MIE dhe H-SH-ja duhet t'i drejtohen dhe të përfshijnë edhe subjekte të tjera shtetërore si IKMT dhe Bashkitë në territorin e të cilave janë ndërtuar këto kalesa hekurudhore.
- HSH-ja në bashkëpunim me MIE-n të marrin masa që të hartojnë një regjistër/bazë të dhënash ku të regjistrojnë të dhënash specifike mbi vonesat e trenave dhe arsyet e vonesave.
- HSH-ja në bashkëpunim me MIE-n të marrin masa për zëvendësimin e të gjitha asetëve hekurudhore si traversa, ballasti, shina, tabela sinjalizuese, aksesore etj. të cilat janë evidentuar nga strukturat përgjegjëse hekurudhore si të amortizuara.
- HSH-ja në bashkëpunim me MIE-n të marrin masa për përmirësimin e gjendjes së veprave të artit dhe veçanërisht urave të dëmtuara dhe të dalta jashtë funksionit nga shkaqe natyrore, me qëllim bërjen funksionale të linjave hekurudhore që kalojnë në këto vepra arti.

Efektiviteti i shërbimit të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale

Pyetja kryesore | A është efektiv shërbimi i IEVP-ve në Shqipëri për periudhën 2016-2019?

Mesazhi i auditimit:

Nga auditimi u konstatua se, rritja e pozicioneve vakante në sistemin e burgjeve dhe rrjedhimisht rritja e ngarkesës së punës për punonjësit aktual ul eficiencën e shërbimit të këtij sistemi. Diferencimi në statusin e punonjësit të Policisë së Shtetit dhe atij të Policisë së Burgjeve e ka bërë më pak të preferuar këtë të fundit. Kjo ka ndodhur si pasojë e kushteve të vështira në arsimim dhe kualifikim, shpërblim dhe logjistikë për Policinë e Burgjeve. Ndërsa, përdorimi i komandimit në detyrë në mënyrë të vazhdueshme nuk motivon drejtuesit e IEVP-ve, duke ndikuar edhe në eficiencën e punës. Akti i fundit që rregullon shpërblimin e të dënuarve daton që në vitin 1993, shumë kohë përpara miratimit të vetë ligjit për të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve. Kjo ka bërë që puna në IEVP të konsiderohet si një mjet për të përfituar uljen e ditëve nga dënimi dhe jo një mjet për të siguruar disa të ardhura. Heqja e lirisë është një dënim në vetvete dhe si rezultat, regjimi për të burgosurit nuk mund të përkeqësoj vuajtjen e burgimit me infrastruktura të amortizuara dhe ushqyerje jo të shëndetshme. Pavarësisht përpjekjeve të IEVP-ve për të realizuar trajnime në përmbushje të misionit të riintegrit të të dënuarve, shifrat e larta të recidivistëve shfaqin mungesë efektiviteti për formën e hartimit, zhvillimit dhe ndjekjes së trajnimeve edukuese.

Subjektet nën auditim:

Ministria e Drejtësisë
Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

Mbi Auditimin

Për përmirësimin e situatës janë dhënë një sërë rekomandimesh, ku ato më kryesoret kanë të bëjnë me:


- Ministria e Drejtësisë, me asistencën e Drejtorisë së Burgjeve apo në bashkëpunim me institucione të tjera, të shqyrtojë mundësinë e ndryshimit të procesit të pranimit në Policinë e Burgjeve, në linjë me procesin e aplikuar nga Policia e Shtetit (nëpërmjet një institucioni si Akademia e Sigurisë), me qëllim të mëtejshëm ndryshimin e statusit dhe nivelit të kualifikimit të punonjësve të Policisë së Burgjeve në linjë me ata të Policisë së Shtetit.
- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të propozojë pranë Ministrisë së Drejtësisë emrat për drejtues të IEVP-ve, me qëllim emërimin e tyre, duke e ruajtur komandimin si një mjet të përkohshëm për situata të caktuara.
- Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të rishikojnë normën ushqimore të të dënuarve ku të parashikojnë moshën e të dënuarve, shëndetin, kushtet fizike, fenë, kulturën dhe natyrën e punës që kryejnë si dhe në respektim të rekomandimeve të Këshillit të Evropës mbi rregullat e burgjeve.
- Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, së bashku me IEVP-të përkatëse të nxisin punësimin e të dënuarve në subjekte të tjera jashtë institucionit ku vuajnë dënimin, nëpërmjet fushatave promovuese, marrëveshjeve të bashkëpunimit, etj.
- Ministria e Drejtësisë të bëjë përditësimin e Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr. 2259, datë 11.03.2008, duke reflektuar ndryshimet që kanë ndodhur ndër vite në sistemin e burgjeve.
- IEVP Rrogozhinë në bashkëpunim me institucionet rajonale arsimore, të marri masa për të bërë efektive marrëveshjet ndër-institucionale në kuadër të zhvillimit të procesit arsimor në burg për arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar.
- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bashkëpunim me IEVP-të, të kujdeset për të mundësuar trajnime dhe kualifikime të veçanta në fushat përkatëse, duke monitoruar procesin dhe përmbajtjen e kurikulave të trajnimit në vazhdimësi.
- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bashkëpunim me IEVP-të, të orientojnë praktikën e programeve të individualizuara profesionale drejt modeleve ndërkombëtare dhe metodave interaktive.

Gjetjet, Konkluzionet dhe Rekomandimet të ndara sipas dimensionit të 3E-ve të performancës

Tabela nr. 15 Dimensionet e Performancës së 3E-ve


Dim. Perf. 3E-te	Gjetje	Konkluzione	Rekomandime		
			Masa organizative	Për përmisim ligjor	Shuma
Ekonomicitet	0	0	0	0	0
Eficcencë	61	38	46	2	48
Efektivitet	249	166	164	12	176
Total	310	204	210	14	224

Grafik nr. 15 Gjetjet, konkluzionet në auditimet e performancës



Burimi KLSH

Grafik nr. 16 Masat e rekomanduara



Burimi KLSH

VI. Auditimet e Teknologjisë së Informacionit

Departamenti i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2020 ka ushtruar 10 auditime në subjekte të cilat kanë sisteme të teknologjisë së Informacionit, që menaxhojnë të ardhurat dhe shpenzimet e buxheteve të pushtetit qendror dhe atij vendor.

Për vitin 2020 janë evaduar 5 auditime IT.

Instituti i Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit dhe Mjedisit;

Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile;

Ujësjetës Kanalizime Fier SHA;

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave;

Zbatimi i Rekomandimeve të lëna nga KLSH për auditimet e evaduara në 2019.

Për vitin 2020 janë audituar dhe janë konstatuar në subjektet e paraqitura:

16 Gjetje Rekomandime në subjektin Institutin e Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit dhe Mjedisit;

16 Gjetje Rekomandime në subjektin Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile;

23 Gjetje Rekomandime në subjektin Ujësjetës Kanalizime Fier SHA;

23 Gjetje Rekomandime në subjektin Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Nga analiza e strukturës së gjetjeve sipas fushave të përcaktuara në metodologjinë e Auditimit TI tregon se edhe për këtë periudhë fushat me problematike të teknologjisë së informacionit ngelen:

1. Qeverisja TI
2. Siguria e Informacionit
3. Zhvillimi dhe blerja

Auditimi TI në Institutin e Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM)

- Nga auditimit rezultoi se IGJEUM e zhvillon aktivitetin me 67.6 % të organikës së miratuar, dhe pa strukturë TI, çka mbart risk në plotësimin e detyrave institucionale si:
 - Studimi dhe vlerësimi i fenomeneve gjeologjike e burimeve natyrore të vendit;
 - Vlerësimi i riskut sizmik, meteorologjik dhe hidrik në shkallë lokale dhe kombëtare;
 - Monitorimi 24/7 i aktivitetit sizmik, meteorologjik dhe hidrik të vendit, duke mundësuar shpërndarjen e të dhënave në kohë reale për vendimmarrësit dhe opinionin e gjerë.

Mungesa e akteve rregullatore, mos trajtimi dhe zgjidhja e problematikave të shfaqura, ka sjellë risqe në drejtim të sigurisë së të dhënave.

Ekzistenca e IGJEUM nën varësinë e Universitetit Politeknik të Tiranës, ka ndikuar në një mungesë të theksuar të vëmendjes për krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin pa ndërprerje të monitorimit të aktivitetit sizmik, meteorologjik dhe hidrologjik, gjendja e stacioneve të shpërndara në të gjithë territorin e vendit, të cilat rrezikojnë të mos përmbushin plotësisht objektin e tyre, ose të dëmtohen në mënyrë të pariparueshme.

Pasojat e mungesës së investimeve të domosdoshme në drejtim të teknologjisë së informacionit dhe më gjerë, janë vënë re gjatë ngjarjeve të fundit në vend. Konkretisht, referuar regjistrimeve të bëna në dispozicion nga Departamenti i Sizmologjisë në IGJEUM në lidhje me tërmetin e datës 26.11.2019, i cili ka patur impakt në jetë njerëzish dhe dëme të shumta materiale, konstatohet se mungojnë të dhëna të plota nga stacioni i Durrësit, i cili është stacioni më i afërt me vatrën e tërmetit. Ky stacion ka regjistruar vetëm 15 sekonda të para të tërmetit, si pasojë e ndërprerjes së energjisë elektrike. Nisur nga fakti që gjatë një tërmeti të fortë ekziston një probabilitet i lartë për ndërprerjen e energjisë elektrike, është e domosdoshme pajisja e stacioneve sizmologjike me bateri (UPS) të cilat mundësojnë regjistrimin e të dhënave edhe nëse ndërpritet energjia elektrike.

Theksojmë se funksionimi i rregullt i tre rrjeteve sizmike në vendin tonë është i rëndësishme për parashikimin dhe monitorimin e katastrofave natyrore në kohë reale, duke marrë masa në drejtim të mbrojtjes së jetës së njerëzve dhe reduktimin e dëmeve materiale.

Auditimi TI në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes (AKMC)

Nga auditimi i TI në AKMC rezultoi se tërmetet që ndodhën në fund të vitit 2019 në Shqipëri e gjetën këtë Agjenci në proces shndërrimi të pa përfunduar (nga Drejtori Kombëtar të Mbrojtjes Civile në vartësi të Ministrisë së Brendshme në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile në vartësi të Ministrisë së Mbrojtjes) proces i cili u zbatuar duke mos ndjekur praktikën me të mira për menaxhimin e ndryshimit.

Ngjarjet e vitit 2019 e gjetën AKMC:

- Të pa plotësuara me burime njerëzore
- Me Plan Kombëtar të Emergjencave Civile të pa përditësuar (duke mos iu përshtatur realitetit me ndodhitë që kanë ndodhur për 16 vite në Shqipëri, bazuar në ligjin nr. 8756, datë 26.03. 2001, " Për emergjencat civile", i ndryshuar).
- Pa Strategji Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë.
- Pa sisteme të teknologjisë së Informacionit në dispozicion.
- Pa regjistër ngjarjesh të konsideruara emergjente të ndodhura apo të raportuara sipas shpërndarjes gjeografike, që ato kanë pasur brenda vendit të cilat lidhen me dukuri natyrore ekstreme si: tërmetet, përmblytjet dhe vërshimet e ujit, temperaturat ekstreme dhe të tej zgjatura, rrëshqitjet arkitektonike, ortekët, erërat e forta në tokë dhe në det, zjarret masive në pyje, sëmundjet infektive masive dhe dukuri të tjera që ndikojnë në jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin.
- Me strukturat të emergjencave civile që vuajnë nga koordinimi i dobët, mungesa e informacionit, e logjistikës, fondeve dhe kapaciteteve për të ndërhyrë.

- Me komunikimi që kryhet nëpërmjet shkëmbimeve verbale, nëpërmjet celularit, whatsapp ose nëpërmjet e-maileve.
- Mungojnë informacionet e paralajmërimit të hershëm të fatkeqësive.
- AKMC nuk ka konsideruar infrastrukturën kritike të qendëruara të bazave të të dhënave shtetërore si dhe qendrën e të dhënave të cilat jo vetëm janë të vetmet në vend por edhe një investim tejet i lartë në vlerë dhe rëndësi sipas përcaktimeve të nenit 43 të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjes civile" mbi telekomunikacionin (rrjetet, sistemet).

Ujësjetllës Kanalizime Fier SHA

Nga auditimi i TI në Ujësjetllës Kanalizime Fier SHA ka zhvilluar sisteme të Teknologjisë së Informacionit pa hartuar bazën e nevojshme rregullatorë për funksionimin e tyre dhe të pa mbështetura me burimet e nevojshme njerëzore. Investimet në sistemet e informacionit nuk kanë zgjidhur përfundimisht problemet e sigurisë së informacionit, sigurimin e Vazhdueshmërisë së Biznesit dhe nuk kanë siguruar Rimëkëmbjen nga Katastrofat. Zhvillimi i shërbimeve dhe infrastrukturës duhet të mbështetet në praktikën më të mirë si dhe rekomandimet e AKSHIT. Të dhënat e ruajtura në sistemet nuk janë të sigurta. Gjenerimi i faturave nga UKF SHA. është në kundërshtim me Ligjet Tatimore.

Sistemet TI janë të kompromentuar nga mungesa e Strategjisë TI, dhe mbartin riskun e keq adresimit të burimeve të limituara financiare që ka UKF SHA për mbështetje e veprimtarisë së saj.

Nga auditimi rezultoi se Ujësjetllës Kanalizime Fier SHA:

- nuk ka Strategji Për Teknologjinë e Informacionit, mungesa e të cilës sjell mos pasqyrimin e objektivave lidhur me infrastrukturën, burimet e nevojshme si dhe instrumente të nevojshëm për matjen e objektivave. Mungesa e Planit Strategjik, mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së Ujësjetllës Kanalizime Fier SHA;
- nuk ka politika mbi sigurinë dhe Vazhdueshmërisë së Punës së Institucionit. Ujësjetllës Kanalizime Fier Sh.a dhe nuk ka krijuar kushtet e nevojshme për vënien në dispozicion rregulloreve të gjithë punonjësve përgjegjës mbi sigurinë e informacionit, përfshirë përdoruesit e sistemeve të cilët kanë rol në mbrojtjen e informacionit me qëllim që të gjithë punonjësit të familjarizohen dhe ta bëjnë pjesë të mënyrës së të menduarit dhe të veprimtarisë së tyre të përditshme;
- Struktura IT nuk ka një bazë rregullative të plotësuar (rregullorja e strukturës IT dhe ndarja e detyrave, rregullore për sigurinë dhe komunikimet elektronike, dokumentacion mbi procedurat e backup, dokumentacion mbi procedurat e veprimeve në sistem etj);
- Organizimi i strukturës IT-së nën Sektorin e Burimeve Njerëzore, nuk i përgjigjet shtrirjes së teknologjisë së informacionit në Ujësjetllës Kanalizime Fier Sh.a. duke zbehur ndikimin e varësisë direkt nga menaxhimi i lartë;
- Nuk ka plan trajnimi vjetor për burimet njerëzore të sektorit të Teknologjisë e Informacionit. Nga ana e burimeve njerëzore dhe Sektorit të Inovacionit IT dhe

mbrojtjes Kibernetike nuk dokumentohet procesi i kërkesave, nevojave dhe analizimi i tyre. Trajnimet e përfituara nga donatorët dhe zhvilluesit e sistemeve janë të pa mjaftueshme e nuk plotësojnë nevojat për trajnim mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit për stafin IT;

- Ujësjetës Kanalizime Fier SHA ka regjistër risku për teknologjinë e informacionit të pa miratuar dhe në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik;

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave

KLSH duke vlerësuar rolin e teknologjisë së informacionit në përmbushjen e misionit të DPA mbështetur në Standardet ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH" datë 27.11.2014 konstaton se, mungesa e akteve rregullatorë në drejtim të sistemeve të teknologjisë së informacionit kanë ndikuar në një zhvillim të pa monitoruar të aktivitetit institucional dhe pa deleguar përgjegjësitë individuale për veprimet e kryera.

Nisur nga vlerësimi i strategjisë institucionale, si dhe zhvillimet bashkëkohore në fushën e teknologjisë së informacionit, konstatohet se ka mos përditësim apo mungesë e akteve rregullatorë në lidhje me krijimin, ruajtjen dhe arkivimin e dokumentit elektronik. Materializimi i këtij hendeku ligjor, kërkon gjithë përfshirje dhe impenjimin e AKSHI-t, Këshillit të Ministrave dhe DPA-së, veprim i cili do të ndihmonte jo vetëm Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, por të gjithë administratën publike e cila ka implementuar sisteme të teknologjisë së informacionit dhe ka një bazë të dhënash, të dhëna të cilat në të ardhmen do të jenë fond arkivor i DPA-së.

Siguria e Informacionit dhe perspektiva e DPA është e kompromentuar nga mungesa e investimeve në rrjetin network si dhe nga mos përfshirja e DPA në rrjetin GOV.

Nga analizimi i të dhënave me teknikat CAAT, rezultoi se sistemi nuk ka mekanizmat e nevojshme për kontrollin e inputit, duke rritur riskun e popullimit të sistemit me të dhëna të gabuara, e për pasojë nxjerrjen e raporteve të pasakta.

Kushtet fizike të Arkivave Vendore janë në një situatë të tillë që krijojnë risk të lartë për prishjen e dokumentacionit të ruajtur.

Grupi i auditimit vlerëson se përdorimi i teknologjisë së informacionit do të ndikonte në përmirësimin e nivelit të sigurisë mbi dokumentacionin e arkivuar si dhe krijimin e kushteve më të përshtatshme për ruajtjen e tyre.

Ndër gjetjet më kryesore të auditimit TI në DPA (për të cilat janë lënë rekomandimet përka tëse për përmirësimin e gjendjes) po rendisim:

- Shërbimet e ofruara me anë të Teknologjisë së Informacionit në DPA mbështeten në një infrastrukture IT (rrjeti netëork) të amortizuar, shërbimet e ngriura mbi këtë rrjet nuk janë të sigurta dhe nuk mbështesin vazhdimësinë e punës dhe perspektivën e zhvillimeve të përcaktuara në planin strategjik 2020-2030.

- Ambientet e mbajtjes se serverave të DPA-së nuk plotësojnë kushtet teknike të përcaktuara në Rregulloren e miratuar nga AKSHI "Për ndërtimin e dhomës së serverëve" (versioni 1.0, datë 02.12.2008). Dhoma e serverave si vendi fizik ku ruhen dhe qëndrojnë kryesisht serverat dhe pajisje të tjera ndihmëse që nevojiten për shërbimet e komunikimit dhe ruajtjes së të dhënave është pika më e ndjeshme e sistemeve të teknologjisë së informacionit të një institucioni.

Nga auditimi u konstatua se sistemi i hyrje-daljeve në DPA nuk garanton akses të sigurtë pasi në sistem rezultojnë:

- Në 14 raste ka karta akses pa emër e mbiemër në sistem.
- Në 44 raste llogari në akses pa emër ose përdorimi i numrave.
- Në 2 raste me status active pa të dhëna të plota.
- Në 3 raste me status inactive (data issue dhe aktivizimit e njëjtë).
- Në 9 raste pa status dy prej tyre kanë datë aktivizimi.
- Në 430 raste pa role përdorues.
- DPA nuk përdor sisteme TI për akses të kontrolluar sigurie të dhomave të arkivimit dhe raftëve.

Nga verifikimi i sigurisë në ambienteve të DPA dhe arkivave në rrethe rezultoi se:

- Siguria fizike në Godinat e DPA (ambientet e brendshme) ka risk të komprometohet, pasi mungesa e kamerave në ambientet e brendshme mbart riskun e humbjes së dokumenteve e modifikimit të tyre (rasti i humbjes së një vule në vitin 2019 dhe ri gjetjes së saj pa gjetur autorin).
- Niveli i përdorimit të Teknologjisë së Informacionit për krijimin e kushteve të nevojshme (temperaturës, lagështirës, mbrojtja kundër zjarrit dhe sigurisë) në ambientet e ruajtjes së dokumenteve është i ulët.

Nga verifikimi i user-ave të katalogut, u konstatua se në fushën "Id" të user-ave, mungojnë Id=1, Id=15, Id=16 dhe Id=17. Ndërsa nga verifikimi i user-ave publik, u konstatua se mungojnë gjithsej 262 Id përdoruesish. Mungesa e këtyre Id-ve tregon se këto user-a janë fshirë. Nëse një user e mbaron objektin për të cilin është krijuar, ai duhet të bëhet "disable", dhe jo të fshihet pasi ndikon në humbjen e gjurmës audituese.

Nga verifikimi i fushave të plotësuara për user-at e katalogut, u konstatua se:

- Tek fusha "email", i njëjti email është përdorur për dy user-a të ndryshëm.
- Në një rast, fusha "name", është e plotësuar me një adresë email-i, e cila është e njëjtë me fushën "email", duke mos ditur se cili është punonjësi me këtë user.

Nga verifikimi i fushave të plotësuara për user-at publik, u konstatua se:

- Në 19 raste, i njëjti individ paraqitet me dy numra letërnjoftimesh të ndryshme.
- Në 24 raste, i njëjti numër letërnjoftimi është përdorur për dy user-a të ndryshëm, duke evidentuar faktin se sistemi nuk e parandalon përdorimin e të njëjtit numër letërnjoftimi, fushë e cila është e vetmja që përfaqëson një të

dhënë unike për përdoruesit, për disa user-a. Edhe pse nga verifikimi i detajuar, user-at me të njëjtën numër letërnjoftimi praktikisht janë i njëjti individ, fakti që ndryshon minimalisht një karakter, bën që sistemi ti njohë si dy user-a të ndryshëm, çka vërteton se i njëjti numër letërnjoftimi mund të përdoret për dy apo më shumë user-a.

- Numri i letërnjoftimit, si fusha e vetme që përfaqëson një të dhënë unike për përdoruesit, e cila mund të bëjë identifikimin e tij, nuk ka mekanizëm kontrolli të inputit.

Në vlerësim të grupit të auditimit, elementët e mësipërm ndikojnë në rritjen e riskut të cenimit të sigurisë së sistemit, pasi user-at nuk janë unik, e për pasojë nuk janë plotësisht të identifikueshëm.

Nga auditimi u konstatuan user-a, të cilët edhe pse kanë përfunduar objektin e tyre si user-a (në këtë rast, nuk janë më në marrëdhënie pune), vazhdojnë ende të jenë aktiv, pra nuk janë bërë "disable", veprim i cili përbën risk të lartë për ndërhyrje të paautorizuara në sistem duke mos lënë gjurmë mbi aktivitetin që kanë kryer.

Konkluzione dhe opinionet e Auditimit

Tabela nr.15 Opinionet e auditimeve IT

Subjektet e Audituar	Opinion i Auditimit
<p>KLSH mbështetur në Standardet ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH" datë 27.11.2014, ka dhënë opinionet si më poshtë</p>	
<p>Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile</p>	<p>KLSH konstaton se, mos përditësimi për një kohë të gjatë i Planit Kombëtar të Emergjencave Civile, mungesa e vlerësimit kombëtar të riskut dhe mungesa e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut si dhe mos menaxhimi i fazës tranzitore të reformimit që po kalon AKMC, kanë sjellë një situatë me risk të lartë në drejtim të funksionimit dhe koordinimit të të gjitha strukturave të emergjencave civile në vend.</p> <p>Identifikimi, përcaktimi, vlerësimi, bashkëpunimi dhe adresimi i burimeve të teknologjisë së informacionit në mbështetje të veprimtarisë së AKMC është i pa pamjaftueshëm.</p> <p>Gjithashtu, AKMC nuk ka konsideruar infrastrukturën kritike të qendëruara të bazave të të dhënave shtetërore si dhe qendrën e të dhënave të cilat jo vetëm janë të vetmet në vend por edhe një investim tejet i lartë në vlerë dhe rendësi.</p> <p>Në gjykimin tonë ekzistenca e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, nën varësi të ministrit, e kufizon atë në ushtrimin e një roli të fortë koordinues ndaj institucioneve të tjera.</p> <p>Për kapërcimin e problematikave të konstatuara në këtë raport dhe rritjes së roli të IT në përmbushje të objektivave të Agjencisë është</p>

	<p>rekomanduar hartimi i Strategjisë Institucionale ku pjesë e saj të bëhen edhe elementët e teknologjisë së informacionit.</p>
<p>Instituti i Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit dhe Mjedisit;</p>	<p>KLSH konstaton se, Ushtrimi i aktivitetit të IGJEUM me 67.6 % të organikës, dhe përdorimi i Teknologjisë së Informacionit pa strukturë IT, mbart risk në plotësimin e detyrave institucionale si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Studimi dhe vlerësimi i fenomeneve gjeologjike e burimeve natyrore të vendit; - Vlerësimi i riskut sizmik, meteorologjik dhe hidrik në shkallë lokale dhe kombëtare; - Monitorimi 24/7 i aktivitetit sizmik, meteorologjik dhe hidrik të vendit, duke mundësuar shpërndarjen e të dhënave në kohë reale për vendimmarrësit dhe opinionin e gjerë. <p>Mungesa e akteve rregullatore, mos trajtimi dhe zgjidhja e problematikave të shfaqura, ka sjellë situatë me risk të lartë në drejtim të sigurisë së të dhënave. Mungesa e gjurmës së auditimit nuk jep siguri të arsyeshme mbi rregullshmërinë e përdorimit të sistemeve në IGJEUM.</p> <p>Ekzistenca e IGJEUM nën varësinë e Universitetit Politeknik të Tiranës, i cili ka si qëllim kryesor përmirësimin e aktivitetit universitar, ka ndikuar në një mungesë të theksuar të vëmendjes për krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin pa ndërprerje të monitorimit të aktivitetit sizmik, meteorologjik dhe hidrologjik, objekt i cili në mungesë mund të ndikojë në jetë njerëzish dhe dëme materiale tejet të konsiderueshme.</p> <p>Mungesa e vëmendjes ndaj IGJEUM evidentohet dukshëm në gjendjen e stacioneve të shpërndara në të gjithë territorin e vendit, të cilat rrezikojnë të mos përmbushin plotësisht objektin e tyre, ose të dëmtohen në mënyrë të pariparueshme.</p>
<p>Ujësjellës Kanalizime Fier SHA</p>	<p>KLSH konstaton se, Ujësjellës Kanalizime Fier SHA ka zhvilluar sisteme të Teknologjisë së Informacionit pa hartuar bazën e nevojshme rregullatorë për funksionimin e tyre dhe të pa mbështetura me burimet e nevojshme njerëzore. Investimet në sistemet e informacionit nuk kanë zgjidhur përfundimisht problemet e sigurisë së informacionit, sigurimin e Vazhdueshmërisë së Biznesit dhe nuk kanë siguruar Rimëkëmbjen nga Katastrofat. Zhvillimi i shërbimeve dhe infrastrukturës duhet të mbështetet në praktikat më të mira si dhe rekomandimet e AKSHIT.</p> <p>Të dhënat e ruajtura në sistemet nuk janë të sigurta. Gjenerimi i faturave nga UKF Sh.a. është në kundërshtim me Ligjet Tatimore. Sistemet TI janë të kompromentuar nga mungesa e Strategjisë TI, dhe mbartin riskun e keq adresimit të burimeve të limituara financiare që ka UKF Sh.a. për mbështetje e veprimtarisë së saj.</p>
<p>Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave</p>	<p>KLSH, mbështetur në Standardet ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH" datë 27.11.2014 konstaton se, mungesa e akteve rregullatorë në drejtim</p>

të sistemeve të teknologjisë së informacionit kanë ndikuar në një zhvillim të pa monitoruar të aktivitetit institucional dhe pa deleguar përgjegjësi të individuale për veprimet e kryera.

Nisur nga vlerësimi i strategjisë institucionale, si dhe zhvillimet bashkëkohore në fushën e teknologjisë së informacionit, konstatohet se ka mos përditësim apo mungesë e akteve rregullatorë në lidhje me krijimin, ruajtjen dhe arkivimin e dokumentit elektronik. Materializimi i këtij hendeku ligjor, kërkon gjithë përfshirje dhe impenjimin e AKSHI-t, Këshillit të Ministrave dhe DPA-së, veprim i cili do të ndihmonte jo vetëm Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, por të gjithë administratën publike e cila ka implementuar sisteme të teknologjisë së informacionit dhe ka një bazë të dhënash, të dhëna të cilat në të ardhmen do të jenë fond arkivor i DPA-së. Siguria e Informacionit dhe perspektiva e DPA është e kompromentuar nga mungesa e investimeve në rrjetin network si dhe nga mos përfshirja e DPA në rrjetin GOV.


Nga analizimi i të dhënave me teknikat CAAT, rezultoi se sistemi nuk ka mekanizmat e nevojshme për kontrollin e inputit, duke rritur riskun e popullimit të sistemi me të dhëna të gabuara, e për pasojë nxjerrjen e raporteve të pasakta. Kushtet fizike të Arkivave Vendore janë në një situatë të tillë që krijojnë risk të lartë për prishjen e dokumentacionit të ruajtur.

KLSH vlerëson se përdorimi i teknologjisë së informacionit do të ndikonte në përmirësimin e nivelit të sigurisë mbi dokumentacionin e arkivuar si dhe krijimin e kushteve më të përshtatshme për ruajtjen e tyre.

VII.REKOMANDIMET SIPAS NATYRËS

KLSH, gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2020, ka adresuar rekomandime për institucionet publike të audituara. Rekomandime për ndryshime apo përmirësime ligjore, organizative, administrative dhe disiplinore gjithsej janë 1430, nga të cilat: 29 janë përmirësime ligjore, 294 rekomandime disiplinore dhe administrative dhe 1107 rekomandime organizative.

Grafik nr.15 Masa e rekomanduara nga KLSH për periudhën Janar - Dhjetor 2020



Burim KLSH


Masat disiplinore

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", KLSH, për të metat dhe shkeljet e konstatuara ka adresuar rekomandimet për masat disiplinore dhe administrative, subjekteve të audituara dhe ka bërë publike rezultatet e auditimeve në media-n e shkruar dhe atë elektronike. Gjithashtu, për shkeljet e konstatuara në bazë të ligjit të mësipërm, Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", neni 58 dhe Kodin e Punës, KLSH u ka kërkuar organeve respektive shqyrtimin dhe marrjen e 294 masave disiplinore dhe administrative, si më poshtë:

Tabela nr. 16 Masat disiplinore dhe administrative


Masa disiplinore bazuar në:		Në numër	
I	Ligjin nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", neni 58:	Rek	Pran
	Vërejtje	11	11
	Mbajtja deri 1/3 të pagës	17	17
	Pezullim ngritje në detyrë	3	3
	"Largim nga shërbimi civil"	1	1
	Në kompetencë të titullarit (Nga Vërejtje deri në largim nga shërbimi civil)	58	49
II	Kodin e Punës dhe Kontratën Kolektive apo Individuale të Punës:	Rek	Pran
	Vërejtje	66	46
29	Vërejtje më paralajmërim	31	29
	Zgjidhje Kontratës së Punës	5	5
	Në kompetencë të titullarit (Nga Vërejtje deri në largim nga puna)	47	44
III	Masat Administrative:	Rek	Pran
	Kompetencë të APP-së, IMTV-së, etj.	51	29
	Ministrisë, Linjës, Heqje Licence	4	4
IV	Shuma (I+II+III)	294	235

Grafik nr. 17 Masa disiplinore bazuar në Ligjin nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil"




Burimi KLSH

Grafik nr. 18 Masa disiplinore bazuar në Kodin e Punës dhe Kontratën Kolektive apo Individuale të Punës



Burimi KLSH

Grafik nr. 19 Masat disiplinore dhe administrative të rekomanduara nga KLSH për vitin 2020



Burimi KLSH

Masat disiplinore dhe administrative janë pasqyruar në mënyrë më të detajuar në formularin nr. 4, bashkëlidhur këtij Buletini statistikor.

Masat për ndryshime apo përmirësime ligjore dhe masat organizative

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2020 janë rekomanduar nga KLSH 1136 rekomandime, për ndryshime apo përmirësime ligjore dhe masa organizative.

KLSH ka rekomanduar gjithsej 29 propozime për ndryshime apo përmirësime ligjore, ndryshime që prekin nga rekomandime për amendime në korniza ligjore, raportimin financiar por edhe në përmirësime të kuadrit të brëndshëm rregullativ të institucioneve me synim forcimin e sistemeve të kontrollit të brëndshëm dhe rritjen e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike etj.

Gjithashtu KLSH ka rekomanduar 1107 masa organizative, në drejtim të forcimit të menaxhimit financiar dhe sistemeve të kontrollit.

Rekomandime për ndryshime apo përmirësime ligjore dhe masat organizative janë pasqyruar në mënyrë më të detajuar në formularin nr. 5 dhe 5.1, bashkëlidhur këtij Buletini Statistikor.

VIII. Kallëzimet Penale

KLSH ka luftuar pa kompromis ndaj abuzimeve dhe mashtrimeve financiare me pronën publike, duke synuar përmirësimin e qeverisjes publike nëpërmjet thellimit të luftës pa kompromis ndaj zyrtarëve të korrumpuar, kryesisht adresimin e kallëzimeve penale me akuzat "Shpërdorim detyre", "Shkelje e barazisë në tendera", etj.

KLSH nga auditimet e realizuara për vitin 2020 ka përcjellë 8 kallëzime dhe indicie penale, nga të cilat 5 i janë dërguar prokurorisë si indicie penale, 1 kallëzim penal dhe 2 janë dërguar për vlerësim në Prokurori.

Kallëzim Penal dhe Indicie Penale

- 1) Instituti i Monumenteve të Kulturës (*Indicie për ndjekje penale*);
- 2) Prefektura e Qarkut Tiranë (*Indicie për ndjekje penale*);
- 3) Bashkia Finiq (*Ish-Kreytar i Bashkisë Finiq, në cilësinë e ish-Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Ish Përgjegjës në Sektorin e Procedurave të Prokurimit, në cilësinë e Kryetarit të NJHDT dhe cilësinë e Kryetarit të KVO*), *Ish përgjegjës në sektorin juridik, në cilësinë e anëtarit të NJHDT dhe cilësinë e Kryetarit të NJHDT*);
- 4) Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Përmet (*Ish-Regjistruer, në ish-Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme {aktualisht Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës}, Ish-Regjistruer, Ish specialist hartograf*);
- 5) Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gjirokastër (*Ish-drejtor në Ish-Drejtorinë Rajonale të Agjencisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integrit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Ish-drejtor në Ish-Drejtorinë Rajonale të Agjencisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integrit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit në ish-Drejtorinë Rajonale të Agjencisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integrit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Qarku Gjirokastër*);
- 6) Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" (*Vlerësim të mëtejshëm nga Prokuroria të Raportit Përfundimtar të Auditimit*);
- 7) Ujësjellës Kanalizime Kavajë SH.A (*Indicie për ndjekje penale*);
- 8) Porti Detar Vlorë SH.A (*Për vlerësim të mëtejshëm nga Prokuroria dhe vijëmbesi të Indicies Penale 1133/15 datë 17.12.2018*).

Për 8 kallëzimet penale/indicie penale të përcjella në Prokurori janë kallëzuar 10 persona të konstatuar me shkelje të rënda nga auditimet e KLSH-së, për 9 drejtues të nivelit të lartë e të mesëm dhe 1 specialist.

Aneksë

Evidenca nr.1 Institucionet e audituara nga KLSH, për vitin 2020

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT TË SHTETIT		
1	1	Dega Doganore Durrës
2	2	Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër
3	3	Banka e Shqipërisë
4	4	Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Mbi raportin e Zbatimit të Buxhetit 2019)
5	5	Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit
6	6	Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
7	7	Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Publik
8	8	Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit
9	9	Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Brendshëm
10	10	Zbatimi i rekomandimeve për auditimet e evaduar në vitin 2019
11	11	Auditim Performance me temë "Ecuria e Borxhit Tatimor"
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË INSTITUCIONEVE QENDRORE		
12	1	Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomantik
13	2	Instituti i Monumenteve të Kulturës
14	3	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit
15	4	Inspektorati Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
16	5	Instituti i Statistikave
17	6	Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara (ABP)
18	7	Ministria e Kulturës
19	8	Enti Rregullator i Ujit
20	9	Zbatimi i rekomandimeve për auditimet e evaduar në vitin 2019
21	10	Këshilli i Ministrave
22	11	Prokuroria e Përgjithshme
23	12	Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore
24	13	Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës
25	14	Këshilli i Lartë Gjyqësor
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË NJËSIVE TË VETQEVERISJES VENDORE		
26	1	Bashkia Rrogozhinë
27	2	Agjencia për mbështetjen e vetqeverisjes Vendore (AMVV)
28	3	Bashkia Skrapar
29	4	Bashkia Finiq
30	5	Bashkia Divjakë
31	6	Këshilli i Qarkut Gjirokastrë
32	7	Prefektura e Tiranës
33	8	Bashkia Roskovec
34	9	Bashkia Malësi e Madhe
35	10	Bashkia Maliq
36	11	Bashkia Cërrik
37	12	Bashkia Ura Vajgurore
38	13	Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore
39	14	Drejtoria e Rajonit Qendror (Autoriteti Rrugor Shqiptar)
40	15	Drejtoria Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë
41	16	Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, Bashkia Tiranë

42	17	Zbatimi i Rekomandimeve në 16 subjekte për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara për periudhën 23.09.2019-31.12.2019.
43	18	Zbatimi i rekomandimeve në 12 subjekte (bashkitë Kurbin, Tropojë, Librazhd, Pukë, Mat, Bulqizë, Gramsh, Fushë Arrëz, Tiranë, Tirana Parking, Drejtoria e punëtorëve të qytetit Tiranë Nr,2.
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE, DHE MJEDISIT		
44	1	Drejtoria Vendore e ASHK Mirditë
45	2	Drejtoria Vendore e ASHK Përmet
46	3	Drejtoria Vendore e ASHK Sarandë
47	4	Drejtoria Vendore e ASHK Mallakastër
48	5	Zbatim i rekomandimeve në subjektet e evaduara në gjashtëmujorin e parë të vitit 2019
49	6	Zbatimi i rekomandimeve në subjektet e evaduara në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2019
50	7	Ish-Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe Ish-DRISHMPUT Vlorë (aktualisht Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier)
51	8	Drejtorinë Rajonale të Mjedisit Lezhë dhe Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujrave dhe Turizmit Lezhë
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE DHE INVESTIMEVE TË HUAJA		
52	1	Rezidenca Studentore Nr.2 SHA Tiranë
53	2	Porti Detar Shëngjin SHA
54	3	PortinDetar Vlorë SHA
55	4	Ujësjellës Kanalizime SHA Kavajë
56	5	Zbatimi i rekomandimeve në subjektet e evaduara gjatë vitit 2019
57	6	Projekti: Bulevardi verior dhe rehabilitimi i lumit të Tiranës
58	7	Projekti: Zhvillimi i sektorit privat në Ministrinë e Financave
59	8	Projekti: Lumi i Vlorës Loti I
60	9	Auditimi Tematik në Spitalin Rajonal të Vlorës
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT		
61	1	Auditim IT: Instituti i Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit dhe Mjedisit
62	2	Auditim IT: Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
63	3	Auditim IT: Ujësjellës Kanalizime Fier SHA
64	4	Auditim IT: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave
65	5	Zbatimi i rekomandimeve në subjektet e evaduara gjatë vitit 2019
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCES		
66	1	Auditim Performance me temë: Efektiviteti i procesit të deinstitutionalizimit dhe decentralizimit të shërbimeve shoqërore me fokus fëmijët jetim
67	2	Auditim Performance me temë: Eficienca e energjisë
68	3	Auditim Performance me temë: Ndotja e menjëhershme e Jonit dhe Adriatikut
69	4	Auditim Performance me temë: Efektiviteti i politikave në lëvizjet migratore të popullsisë
70	5	Auditim Performance me temë: Efektiviteti i koordinimit ndërinstitucional në kuadër të procesit të integritetit të Shqipërisë në BE për periudhën 2016-2019
71	6	Auditim Performance me temë: Shërbimi Shëndetësor në arsimin parashkollor
72	7	Auditim Performance me temë: Menaxhimi i Transportit Hekurudha në Shqipëri
73	8	Auditim Performance me temë: Efektiviteti i Shërbimit të Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale

Shënime

**DRM Vlorë i është nënshtruar ristrukturimit, duke u zgjeruar me disa qarqe tjera, duke ndryshuar organikën e strukturën e saj, me emërtimin Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier*

**DR ISHMPUT Vlorë i është nënshtruar shkrijes saj së bashku me inspektoratet e tjera në kuadrin e reformimit në shkallë vendi të këtij institucioni.*

Evidenca nr.2

Evidenca përmblledhëse e shkeljeve me dëm ekonomik të konstatuar gjatë auditimeve të ushtruara për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2020

Mijë lekë

Nr.	Subjektet	Gjithsej Zbuluar	Rekomanduar për zhdëmtim	Të pa arkëtueshme
1	Instituti i Monumenteve të Kulturës	697	697	
2	Agjencia e Blerjeve të Përqendruara (ABP)	209,677	209,677	
3	Shërbimi Kombëtar i Punësimit	33,281	33,281	
4	Dega e Doganës Durrës	453,211	453,211	
5	Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër	1,444	1,444	
6	Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	1,662	1,662	
7	Bashkia Rrogozhinë	190,021	190,021	
8	Bashkia Finiq	77,384	77,384	
9	Bashkia Divjakë	15,733	2,511	13,222
10	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore	801	801	
11	Bashkia Cërrik	9,789	9,789	
12	Bashkia Skrapar	5,296	5,296	
13	Bashkia Ura Vajgurore	42,162	42,162	
14	Bashkia Malësi e Madhe	14,572	9,500	5,072
15	Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit	1,450	1,450	
16	ZVASHK Mirditë	23,421	23,421	
17	ZVASHK Përmet	1,822	1,822	
18	DVASHK Sarandë	949,926	949,926	
19	ZVASHK Mallakastër	23,184	23,184	
20	Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe DRISHMPUT Vlorë	1,500	1,500	
21	Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe DRISHMPUT Lezhë	4,982	4,982	
22	Rezidenca Studentore nr. 2 Tiranë SHA	1,194	1,194	
23	Porti Detar Shëngjin SHA	929	929	
24	Porti Detar Vlorë SHA	3,935	3,935	
25	Ujësjellës Kanalizime Kavajë SHA	101,261	101,261	
26	Projekti "Zhvillimi i Sektorit Privat", Ministria e Financave dhe Ekonomisë	4,732	4,732	
27	Projekti "Bulevardi verior dhe rehabilitimi i lumit të Tiranës"	468	468	
	Totali	2,193,692	2,175,398	18,294

Evidenca nr. 3

Evidenca e pasqyrimin të parregullsisve të dispozitave ligjore në fuqi, për të ardhura të munguara ose shpenzime jo në përputhje me parimet e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit, të cilat kanë sjell efekt negativ financiar në të ardhurat e subjekteve dhe buxhetin e shtetit për vitin 2020

Mijë lekë

Nr.	Emërtimi i subjekteve	A Shuma në të ardhura	B Shuma në shpenzime	TOTALI
1	Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik	3,711	1,240	4,951
2	Instituti i Monumenteve të Kulturës	0	8,405	8,405
3	Agjencia e Blerjeve të Përqendruara (ABP)	0	210,052	210,052
4	Shërbimi Kombëtar i Punësimit	0	166,182	166,182
5	Ministria e Kulturës	0	45,700	45,700
6	Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore		26,300	26,300
7	Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër	0	35,229	35,229
8	Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit		24,348,555	24,348,555
9	Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit		36,135,723	36,135,723
10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë: "Zbatimi i Buxhetit të vitit 2019"		199,039	199,039
11	Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Publik	8,695,000		8,695,000
12	Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	1,487,753	11,860,804	13,348,557
13	Banka e Shqipërisë	0	108,874	108,874
14	Bashkia Rrogozhinë	221,658	0	221,658
15	Bashkia Finiq	161,232	139,375	300,607
16	Prefektit të Qarkut Tiranë	67,707	14,399	82,106
17	Bashkia Divjakë	12,325	2,123	14,448
18	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV)	0	3,338	3,338
19	Bashkia Cërrik	0	10,599	10,599
20	Bashkia Skrapar	89,263	9,369	98,632
21	Bashkia Ura Vajguore	246,729	343,492	590,221
22	Bashkia Malësi e Madhe	141,083	130,644	271,727
23	Bashkia Roskovec	111,865	5,409	117,274
24	Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, Bashkia Tiranë			
25	Ish-Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe Ish-DRISHMPUT Vlorë	90,123		90,123
26	Rezidenca Studentore nr. 2 Tiranë SHA	0	77,443	77,443
27	Porti Detar Shëngjin SHA	2,431	5,092	7,523
28	Porti Detar Vlorë SHA	195	5,891	6,086
29	Ujësjetës Kanalizime Kavajë SHA	0	4,307	4,307
	Totali	11,376,401	74,490,878	85,867,279

Evidenca e Masave Disiplinore dhe Administrative të rekomanduara nga KLSH për vitin 2020
Në numër

Nr	Emërtimi i subjekteve	GITHSEJ MASAT		
		A) ME STATUSIN E NEPUNESIT CIVIL	B) ME KODIN E PUNES	C) MASAT ADMINISTRATIVE
		Rek	Rek	Rek
1	Shërbimi Kombëtar i Punësimit	10	0	0
2	Instituti i Monumenteve të Kulturës		1	
3	Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës		1	
4	Agjencia e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore		2	
5	Ministra e Kulturës	1		
6	Dega e Doganës Durrës	28	0	0
7	Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër	1	5	1
8	Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit	1	0	1
9	Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit	1	0	1
10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë: " Mbi Zbatimin e Buxhetit të vitit 2019"	1	0	0
11	Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	1	0	0
12	Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Drejtoria e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik	1	0	1
13	Banka e Shqipërisë	0	1	0
14	Bashkia Finiq	4	8	6
15	Prefektit të Qarkut Tiranë	9	0	6
16	Këshilli i Qarkut Gjirokastrë	0	1	3
17	Bashkia Cërrik	1	1	6
18	Bashkia Skrapar	9	14	1
19	Bashkia Ura Vajgurore	0	0	1
20	Bashkia Malësi e Madhe	4	15	0
21	Bashkia Roskovec	9	14	1
22	Rezidenca Studentore nr. 2 Tiranë SHA	0	15	0
23	Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, Bashkia Tiranë		4	22
24	Porti Detar Shëngjin SHA	0	11	0
25	Porti Detar Vlorë SHA	0	9	5

26	Projekti "Zhvillimi i Sektorit Privat", Ministria e Financave dhe Ekonomisë		8	
27	ZVASHK Mirditë	0	2	0
28	ZVASHK Përmet	0	4	0
29	DVASHK Sarandë	0	15	0
30	ZVASHK Mallakastër	0	18	0
31	Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe DRISHMPUT Lezhë	9	0	0
TOTALI		90	149	55

Evidenca nr.5

Masat për ndryshime apo përmirësime ligjore dhe masat organizative të rekomanduara nga KLSH për vitin 2020

Në numër

	SUBJEKTI	Ndryshime dhe përmirësime legjislativi
		Rek.
1	Instituti i Monumenteve të Kulturës	1
2	Agjencia e Blerjeve të Përqendruara (ABP)	4
3	Enti Rregullator i Ujit	1
4	Aparati i Kryeministrit	1
5	Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës	1
6	Agjencia e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore	1
7	Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Publik	1
8	Banka e Shqipërisë	5
9	Auditim Performance me temë: Efektiviteti i koordinimit ndërinstytucional në kuadër të procesit të integritetit të Shqipërisë në BE për periudhën 2016-2019	4
10	Auditim Performance me temë: Efektiviteti i procesit të deinstytucionalizimit dhe decentralizimit të shërbimeve shoqërore me fokus fëmijët jetim	4
11	Auditim Performance me temë: Efektiviteti i politikave në lëvizjet migratore të popullsisë	2
12	Auditim Performance me temë: Ecuria e Borxhit tatimor	1
13	Auditim Performance me temë: Efektiviteti i Shërbimit të Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale	3
TOTALI		29

Masat Organizative të rekomanduara nga KLSH për vitin 2020

Në numër

Nr	SUBJEKTI	Masa organizative
		Rekomanduar
1	Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik	17
2	INSTAT	15
3	Instituti i Monumenteve të Kulturës	15
4	Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore	8
5	Agjencia e Blerjeve të Përqendruara (ABP)	3
6	Drejtoria e Shërbimit Kombëtar i Punësimit	18
7	Ministria e Kulturës	14
8	Enti Rregullator i Ujit	3
9	Aparati i Kryeministrisë	11
10	Prokuroria e Përgjithshme	7
11	Këshilli i Lartë Gjyqësor	3
12	Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës	1
13	Agjencia e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore	3
14	Dega e Doganës Durrës	6
15	Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër	7
16	Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit	7
17	Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit	7
18	Ministria e Financave dhe Ekonomisë: " Mbi Zbatimin e Buxhetit te vitit 2019"	8
19	Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Publik	7
20	Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	46
21	Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Drejtoria e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik	22
22	Banka e Shqipërisë	15
23	Bashkia Rrogozhinë	10
24	Bashkia Finiq	18
25	Prefektit të Qarkut Tiranë	7
26	Bashkia Divjakë	23
27	Këshilli i Qarkut Gjirokastrë	10
28	Agjencia për Mbështetjen e vetëqeverisjes Vendore (AMVV)	14
29	Bashkia Cërrik	14
30	Bashkia Skrapar	10
31	Bashkia Ura Vajguore	18
32	Bashkia Malësi e Madhe	17

33	Bashkia Maliq	13
34	Bashkia Roskovec	10
35	Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, Bashkia Tiranë	4
36	ZVASHK Mirditë	52
37	ZVASHK Përmet	30
38	DVASHK Sarandë	46
39	ZVASHK Mallakastër	63
40	Ish-Drejtorja Rajonale e Mjedisit dhe ish-DRISHMPUT Vlorë	12
41	Drejtorja Rajonale e Mjedisit dhe DRISHMPUT Lezhë	28
42	Rezidenca Studentore nr. 2 Tiranë SHA	47
43	Porti Detar Shëngjin SHA	21
44	Porti Detar Vlorë SHA	34
45	Ujësjellës Kanalizime Kavajë SHA	51
46	Projekti "Zhvillimi i Sektorit Privat", Ministria e Financave dhe Ekonomisë	12
47	Projekti "Bulevardi verior dhe rehabilitimi i lumit të Tiranës"	12
48	Instituti i Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IT)	16
49	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (IT)	16
50	Ujësjellës Kanalizime Fier SHA (IT)	23
51	Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave (IT)	23
52	<i>Auditim Performance me temë: Efektiviteti i procesit të deinstitutionalizimit dhe decentralizimit të shërbimeve shoqërore me fokus fëmijët jetim</i>	15
53	<i>Auditim Performance me temë: Eficienca e energjisë</i>	42
54	<i>Auditim Performance me temë: Ndotja e menjëhershme e Jonit dhe Adriatikut</i>	9
55	<i>Auditim Performance me temë: Efektiviteti i politikave në lëvizjet migratore të popullsisë</i>	21
56	<i>Auditim Performance me temë: Efektiviteti i koordinimit ndërinstitutional në kuadër të procesit të integritit të Shqipërisë në BE për periudhën 2016-2019</i>	49
57	<i>Auditim Performance me temë: Ecuria e Borxhit tatimor</i>	19
58	<i>Auditim Performance me temë: Sistemi i menaxhimit të shërbimit shëndetësor</i>	20
59	<i>Auditim Performance me temë: Menaxhimi i transportit hekurudhor në Shqipëri</i>	18
60	<i>Auditim Performance me temë: Efektiviteti i shërbimit të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale</i>	13
	TOTALI	1107

EVIDENCA E KALLËZIMEVE PENALE PËR VITIN 2020

Nr.	Subjekti ndaj të cilit është bërë kallëzimi	Nr.prot. data e kallezimit	Nr. Pers	Detyra funksionale	Referenca ligjore për kallëzim penal	Gjendja e kallëzimit	Departamenti që ka konstatuar veprën penale
1	Instituti i Monumenteve të Kulturës	Nr.66/9 Datë 22/06/2020			Indicie për ndjekje penale	Në hetim	Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore
2	Prefektura e Qarkut Tiranë	Nr 1017/9 Datë 08/05/2020			Indicie për ndjekje penale	Në hetim	Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore
3	Bashkia Finiq	Nr.Prot 1048/15 Në datë 11.05.2020	3	1) Ish-Kryetari Bashkisë Finiq, në cilësinë e ish-Titullarit të Autoritetit Kontraktor 2) Ish Përgjegjës në Sektorin e Procedurave të Prokurimit, në cilësinë e Kryetarit të NJHDT dhe cilësinë e Kryetarit të KVO 3) Ish përgjegjës në sektorin juridik, në cilësinë e anëtarit të NJHDT dhe cilësinë e Kryetarit të NJHDT	Konsumim i figurës së veprës penale " Të Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike" parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal, " Falsifikimi i dokumenteve" parashikuar nga neni 186 i KP dhe " Hyrja e paautorizuar kompjuterike" parashikuar nga neni 192/b i KP	Në hetim	Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore
4	Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Përmet	Nr.Prot 901/18 Në datë 30.06.2020	3	1) Ish-Regjistruer, në ish-Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (aktualisht Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës), Përmet 2) Ish-Regjistruer 3) Ish specialist hartograf	Indicie për ndjekje penale lidhur me shkeljet e konstatuara në ish-Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (aktualisht Zyra Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës) Përmet	Në hetim	Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit
5	Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gjirokastrë	Nr.Prot 901/19 Në datë 30.06.2020	3	1) Ish-drejtor në Ish-Drejtorinë Rajonale të Agjencisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Qarku Gjirokastrë	Indicie për ndjekje penale lidhur me shkeljet e konstatuara në ish-Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (aktualisht Zyra Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës) Përmet për pjesën e miratimit të lejeve të legalizimit nga ish-Drejtoria Rajonale	Në hetim	Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit

Nr.	Subjekti ndaj të cilit është bërë kallëzimi	Nr.prot. data e kallesimit	Nr. Pers	Detyra funksionale	Referenca ligjore për kallëzim penal	Gjendja e kallëzimit	Departamenti që ka konstatuar veprën penale
				2) Ish-drejtor në Ish-Drejtorinë Rajonale të Agjencisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Qarku Gjirokastrë 3) Ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit në ish-Drejtorinë Rajonale të Agjencisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Qarku Gjirokastrë	të Agjencisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Qarku Gjirokastrë		
6	Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"	<i>Nr.Prot 1422/14 Në datë 26.02.2020</i>			Vlerësim të mëtejshëm nga Prokuroria të Raportit Përfundimtar të Auditimit	Në hetim	Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja
7	Ujësjiellës Kanalizime Kavajë SH.A	<i>Nr.Prot 1016/8 Në datë 04.06.2020</i>	1	Administratori i Shoqërisë	Indicie për ndjekje penale	Në hetim	Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja
8	Porti Detar Vlorë SH.A	<i>Nr.Prot 974/12 Në datë 04.06.2020</i>			Indicie për ndjekje penale Për vlerësim dhe vijimësi të Indicies Penale me nr.prot 1133/15 datë 17.12.2018	Në hetim	Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

Evidenca e shqyrtimit të ankesave dhe kërkesave drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2020

Shqyrtimi i ankesave dhe kërkesave	Nr.	Verifikuar e rezultuar		Vazhdon verifikimi	Ardhur jashtë kompetencave të KLSH (nuk verifikohet)
		E drejtë	Pa drejtë		
<i>Fushat kryesore të shqetësimit publik</i>					
Për administrim financiar dhe prokurime	32	23		3	6
Administrim dhe kthim të pronës	205	49	12	72	72
Taksa, Tatime e dogana	10	6		4	
Të tjera	54	36	10	6	2
Total	301	114	22	85	80

